MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

SHËRBIMI PËRMBARIMOR

MANUALI

I AKTEVE TË UNIFIKUARA TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË SHTETËRORË



TIRANË, 2026

Përmbajtja

MANUALI I AKTEVE TË UNIFIKUARA TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË SHTETËRORË 11
PJESA I 11
DISPOZITA HYRËSE 11
KAPITULLI I 11
PARATHËNIE 11
1.1 QËLLIMI I MANUALIT 1
1.2 STATUSI JURIDIK I MANUALIT 1
1.3 METODOLOGJIA E PËRDORIMIT TË MANUALIT 2
a. Qëllimi i aktit 2
b. Baza ligjore 2
c. Rastet e përdorimit 2
d. Udhëzimet e plotësimit 2
e. Modeli i unifikuar 2
PJESA II 3
FILLIMI I PROCEDURËS PËRMBARIMORE 3
PRANIMI DHE REGJISTRIMI I KËRKESËS 3
Kompetencat e Kryetarit të Zyrës Përmbarimore 3
Kompetencat e Përmbaruesit Gjyqësor Shtetëror 4
Parim i përgjithshëm 4
Neni 515 të KPC-së ia njeh përmbaruesit kompetencën për plotësimin e mangësive dhe kthimin e dokumentacionit, ndërsa neni 62 i Rregullores ia njeh Kryetarit kompetencën për regjistrimin dhe shpërndarjen e çështjeve pas verifikimit formal të kritereve të regjistrimit. 4
1. URDHËR REGJISTRIMI 5
Qëllimi 5
Baza ligjore 5
Kur përdoret 5
Udhëzime për plotësim 5
2. KËRKESË PËR PLOTËSIM DOKUMENTACIONI 6
Qëllimi 6
Baza ligjore 6
Kur përdoret 6
Udhëzime për plotësim 6

Modeli standard 7
Tabelë përmbledhëse 7
3. VENDIM PËR KTHIMIN E DOKUMENTACIONIT 8
Qëllimi 8
Baza ligjore 8
Kur përdoret 8
Udhëzime për plotësim 8
PJESA III 9
EKZEKUTIMI VULLNETAR 9
1. LAJMËRIM PËR EKZEKUTIM VULLNETAR TË DETYRIMEVE NË TË HOLLA 9
Qëllimi 9
Baza ligjore 9
Kur përdoret 9
Përmbajtja e detyrueshme 9
1.1NJOFTIMI I AKTEVE NË PROCEDURËN PËRMBARIMORE 10
1.1.2. Njoftimi shkresor i akteve 10
Personat juridikë publikë 10
Personat juridikë privatë 10
Njoftimi nëpërmjet postës 10
1.1.3. Refuzimi i marrjes së njoftimit 11
1.1.4. Njoftimi në vendbanim, vendqëndrim ose vendin e ushtrimit të veprimtarisë 11
1.1.5. Njoftimi anëtarit të familjes, fqinjit ose portierit 11
1.1.6. Refuzimi i marrjes nga familjarët ose fqinjët 12
1.1.7. Njoftimi personit të autorizuar 12
1.1.8. NJOFTIMI ME SHPALLJE PUBLIKE DHE EKZEKUTIMI NDAJ DEBITORIT QË NUK I DIHET BANIMI 13
Qëllimi 13
Njoftimi me shpallje publike 13
Natyra juridike 13
Kushtet për përdorimin e njoftimit me shpallje publike 13
a) Pamundësia e njoftimit sipas mënyrave të zakonshme 13
b) Mungesa e vendbanimit ose përfaqësuesit 14
Veprimet paraprake të përmbaruesit 14
Procedura e njoftimit me shpallje publike 14
Personat fizikë 14
Personat juridikë privatë 15
Publikimi elektronik 15
Afati i afishimit 15

1.1.9Ekzekutimi ndaj debitorit që nuk i dihet banimi 15
Kuptimi dhe qëllimi i nenit 522 15
Verifikimet paraprake 15
Kërkesapër emërimin e përfaqësuesit 16
Emërimi i përfaqësuesit nga gjykata 16
Udhëzim praktik për përmbaruesin 16
Rastet kur debitori nuk ka adresë të njohur dhe njoftimet lidhen me një pasuri e paluajtshme 17
1.1.9. NJOFTIMI ELEKTRONIK 17
1.1.10. Mënyra të tjera të njoftimit 18
1.1.11. Dokumentimi i njoftimit 18
1.1.12. Debitori me banim të panjohur 18
2. LAJMËRIM PËR EKZEKUTIM VULLNETAR TË DETYRIMEVE JO NË TË HOLLA 19
Qëllimi 19
Baza ligjore 19
Kur përdoret 19
Përmbajtja e detyrueshme 19
3. DEKLARATA E GJENDJES PASURORE TË DEBITORIT 20
Qëllimi 20
Baza ligjore 20
Detyrimi për deklarim 20
Rëndësia procedurale 20
Pasojat e mosdeklarimit 20
PJESA IV 21
EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM 21
Kuptimi dhe fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm 21
Përjashtimi: Fillimi i menjëhershëm i ekzekutimit 21
Rrethana që mund të justifikojnë fillimin e menjëhershëm 21
1. VENDIM PËR FILLIMIN E EKZEKUTIMIT TË DETYRUESHËM 22
Qëllimi 22
Baza ligjore 22
Kur përdoret 22
2. VENDIM PËR FILLIMIN E MENJËHERSHËM TË EKZEKUTIMIT TË DETYRUESHËM 23
Qëllimi 23
Baza ligjore 23
Kur përdoret 23

Kërkesa për arsyetim ... 23
3. PROCESVERBALI I VEPRIMEVE PËRMBARIMORE ... 24
Qëllimi ... 24
Baza ligjore ... 24
Parimi i përgjithshëm ... 24
Përmbajtja e detyrueshme sipas nenit 524 KPC ... 24
Veprimet për të cilat mbahet procesverbal ... 25
PJESA V ... 26
Kapitulli I ... 26
1. Qëllimi i sekuestros ... 26
2. Baza ligjore ... 26
3. Shtrirja e sekuestros ... 26
4. Pasuritë mbi të cilat nuk mund të vendoset sekuestro ... 27
5. Efektet juridike të vendosjes së sekuestros ... 27
6. Sekuestroja mbi shpërblimin nga sigurimi ... 27
KAPITULLI II ... 28
SEKUESTRO MBI KREDITË E DEBITORIT DHE PASURITË QË PERSONAT E TRETË I DETYROHEN DEBITORIT ... 28
Qëllimi ... 28
1. Deklarimi i pasurive të debitorit ... 28
Udhëzim praktik ... 28
2. Verifikimi i ekzistencës së kredive ... 28
3. Njoftimi i personit të tretë ... 29
4. Kundërshtimi i personit të tretë ... 29
Efektet e kundërshtimit ... 29
5. Dorëzimi i kredive dhe sendeve të sekuestruara ... 30
7. Kreditë e siguruara me peng ose hipotekë ... 30
Kapitulli III ... 30
Sekuestro mbi Pagën dhe të Ardhurat e Debitorit ... 30
Qëllimi ... 30
1. Sekuestroja e pagës ... 30
2. Respektimi i minimumit jetik ... 31
3. Shtrirja e sekuestros mbi shpërblime të tjera ... 31
4. Ndryshimi i vendit të punës së debitorit ... 31
5. Përgjegjësia e punëdhënësit ... 32
Kapitulli IV ... 33
Sekuestro mbi Shumat në Llogaritë Bankare ... 33
Vendosja e sekuestros mbi llogaritë ... 33

4. Transferimi i shumave të sekuestruara 34
Përmbajtja e urdhrit të transferimit të shumës 34
Respektimi i radhës së preferimit 34
5. Sanksionet ndaj bankave 34
Njoftimi i organit financiar sipas nenit 536 të KPC-së 36
Qëllimi 36
Qëllimi i njoftimit 36
Kur përdoret 36
Baza ligjore 36
Përdoret Modeli nr. 26 "Njoftim në zbatim të nenit 536 të Kodit të Procedurës Civile". 36
KAPITULLI V 37
PROJEKTI I NDARJES SË SHUMAVE NDËRMJET KREDITORËVE 37
Baza ligjore 37
1. Pjesëmarrja e kreditorëve në ekzekutim 37
2. Hartimi i projektit të ndarjes 37
Kushtet për hartimin e projektit 37
Parimet që zbatohen 37
3. Njoftimi i projektit të ndarjes 38
5. Miratimi përfundimtar i ndarjes 38
Kapitulli VI 39
Sekuestro mbi Sendet e Luajtshme 39
Qëllimi 39
1. Inventarizimi i sendeve 39
2. Procesverbali i inventarizimit 39
3. Vlerësimi i sendeve 40
4. Lënia në ruajtje e sendeve 40
5. Sendet në bashkëpronësi 40
6. Sekuestrimi i sendeve të çmueshme 41
7. Pavlefshmëria e disponimit pas vendosjes së sekuestros 41
Kapitulli VII 42
Sekuestro mbi Pasuritë e Paluajtshme 42
Nënkapitulli I 42
Qëllimi 42
1. Verifikimi i pronësisë së debitorit 42
2. Urdhri i vendosjes së sekuestros 42
Nënkapitulli II 43
Qëllimi 43

1. Marrëveshja e palëve mbi vlerën ... 43
2. Caktimi i ekspertit ... 43
Udhëzim praktik ... 43
3. Raporti i ekspertit ... 44
4. Vendimi për përcaktimin e vlerës ... 44
Përmbajtja e vendimit ... 44
Nënkapitulli III ... 45
Qëllimi ... 45
1. Lënia në ruajtje e pasurisë ... 45
2. Caktimi i personit ruajtës ... 45
Shpërblimi i ruajtësit ... 45
Udhëzim praktik ... 46
3. Të ardhurat dhe shpenzimet e pasurisë ... 46
Përgjegjësia e ruajtësit ... 46
Kapitulli VIII ... 47
Sekuestro mbi Automjetet ... 47
Qëllimi ... 47
1. Verifikimi në DPSHTRR dhe Vendosja e Sekuestros ... 47
Efektet juridike ... 47
Baza ligjore ... 47
4. Kërkesa për bllokim fizik të automjetit nëpërmjet bashkëpunimit të Policisë Rrugore ... 48
5. Inventarizimi dhe Marrja në Ruajtje e Automjetit ... 48
6. Lënia në Ruajtje ose Sekuestrimi Fizik ... 48
a) Automjeti lihet në ruajtje te debitori ... 48
b) Automjeti merret fizikisht ... 48
6. Kalimi në Procedurën e Shitjes ... 49
Kapitulli IX ... 50
Sekuestro mbi Kuotat dhe Aksionet në Shoqëritë Tregtare ... 50
1. Verifikimi në QKB ... 50
Qëllimi ... 50
Veprimet procedurale ... 50
2. Vendosja e sekuestros ... 50
Baza ligjore ... 50
Kapitulli X ... 51
Sekuestro mbi Mjetet e Lundrimit dhe të Fluturimit ... 51
1. Sekuestro mbi anijet ... 51
Qëllimi ... 51

Baza ligjore 51
Veprimet procedurale 51
2. Sekuestro mbi mjetet e fluturimit 52
Qëllimi 52
Veprimet procedurale 52
KAPITULLI XI 52
EKZEKUTIMI I DETYRIMIT PËR KRYERJEN OSE MOSKRYERJEN E NJË VEPRIMI TË CAKTUAR 52
Qëllimi 52
Baza ligjore 52
1. Kuptimi i detyrimit për kryerjen e një veprimi 53
2. Veprimi që mund të kryhet nga persona të tjerë 53
Kushtet 53
3. Vendimi për autorizimin e kreditorit 53
4. Shpenzimet e kryerjes së veprimit 53
5. Detyrimet për moskryerjen e një veprimi 54
6. Sanksionet ndaj debitorit 54
Personat e tjerë të detyruar 54
7. Dokumentimi i procedurës 54
8. Kërkesa për bashkëpunim institucional 54
PJESA VII 55
ANKANDET 55
Qëllimi 55
Kapitulli I 55
Pasuritë e Paluajtshme 55
1. Vendim për zhvillimin e ankandit 55
2. Ankandi I 55
3. Ankandi II 56
4. Ankandi III 56
5. Deklarata e mungesës së konfliktit të interesit 56
6. Kalimi i pronësisë 57
7. Marrja në pronësi nga kreditori 57
Kapitulli II 58
Sendet e Luajtshme 58
1. Ankandi I 58
2. Ankandi II 58
PJESA VIII 59
PEZULLIMI, PUSHIMI I PROCEDURËS 59

Qëllimi ... 59
Kapitulli I ... 60
Pezullimi i Procedurës së Ekzekutimit ... 60
1. Vendim për pezullim ... 60
2. Vendim për transferim për kompetencë tokësore ... 60
Kapitulli II ... 61
Pushimi i Procedurës së Ekzekutimit ... 61
3. Vendim për pushim ... 61
a. Kur detyrimi është ekzekutuar ... 61
b. Kur kreditori heq dorë nga ekzekutimi ... 61
c. Kur titulli ekzekutiv shpallet i pavlefshëm ... 61
ç. Kur pranohen ankimet kundër procedurës përmbarimore ... 61
Kapitulli III ... 62
Heqja e Sekuestros ... 62
4. Urdhër për heqje sekuestroje ... 62
Veprimet që kryhen ... 62
Urdhër për heqje sekuestroje pas pushimit ... 62
PJESA IX ... 63
EKZEKUTIMI NDAJ INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE SEKUESTROJA NË DEGËN E THESARIT ... 63
Qëllimi ... 63
Kapitulli I ... 63
Ekzekutimi ndaj Institucioneve Buxhetore ... 63
1. Baza ligjore ... 63
2. Njoftimi për ekzekutim vullnetar ... 63
3. Procedura e pagesës vullnetare ... 63
Kapitulli II ... 64
Vendosja e Sekuestros në Degën e Thesarit ... 64
1. Kushtet për vendosjen e sekuestros ... 64
2.Urdhri për vendosjen e sekuestros në degë të thesarit ... 64
5. Vendosja e masës së sekuestros ... 65
6. Kufizimet ligjore të sekuestros ... 65
Kapitulli III ... 65
Përfundimi i Procedurës ... 65
1. Shlyerja e detyrimit ... 65
2. Heqja e sekuestros ... 65
PJESA X ... 66
EKZEKUTIMI I GJOBAVE PENALE ... 66

Qëllimi 66
Kapitulli I 66
Fillimi i Procedurës së Ekzekutimit 66
Kapitulli II 66
Kërkesa për Qëndrim mbi Amnistinë 66
1. Verifikimi paraprak 66
2. Kërkesa drejtuar Prokurorisë 66
Kapitulli III 67
Kërkesa për Konvertimin e Gjobës në Burgim 67
1. Pamundësia e ekzekutimit 67
2. Njoftimi i Prokurorisë 67
3. Kërkesa për konvertim 67
PJESA X1 68
ANEKS - Modelet e formularëve 68

Udhëzim nr. 1, datë 29.06.2026 i Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit "Për procedurën e regjistrimit të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëherëshëm të mbrojtjes nga Zyrat Përmbarimore Vendore" 193

Udhëzim nr. 2, datë 30.06.2026 i Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit "Për procedurën e ekzekutimit të titujve ekzekutivë me objekt 'Takim fëmije' dhe 'Marrje e fëmijës në kujdestari' dhe asistencën psikologut gjatë ekzekutimit nga zyrat përmbarimore vendore" 198

MANUALI I AKTEVE TË UNIFIKUARA TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË SHTETËRORË

PJESA I

DISPOZITA HYRËSE

KAPITULLI I

PARATHËNIE

Ekzekutimi i titujve ekzekutivë përbën fazën përfundimtare të realizimit të së drejtës dhe një element thelbësor të shtetit të së drejtës. Efektiviteti i sistemit të përmbarimit ndikon drejtpërdrejt në garantimin e të drejtave të subjekteve, besimin e publikut te institucionet dhe funksionimin e drejtësisë në tërësi.

Në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë, ndershmërisë, paanësisë, profesionalizmit, etikës dhe respektimit të të drejtave e interesave të palëve në procesin e ekzekutimit. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror, gjatë ushtrimit të detyrës, përfaqëson autoritetin shtetëror dhe vepron në zbatim të Kushtetutës, Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil, Ligjit nr. 8/2023 dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Në kuadër të rolit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit për garantimin e zbatimit të njëjtë të legjislacionit dhe unifikimin e praktikës përmbarimore, është hartuar ky **Manual i Akteve të Unifikuara të Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë**, si një instrument praktik pune për të gjitha zyrat përmbarimore vendore. Ligji nr. 8/2023 ngarkon Drejtorin e Përgjithshëm të Përmbarimit me detyrimin për të siguruar unifikimin e kuptimit dhe zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, si dhe të praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit.

Manuali paraqet modele të unifikuara të akteve procedurale dhe administrative që përdoren gjatë ushtrimit të veprimtarisë përmbarimore, duke synuar krijimin e standardeve të përbashkëta profesionale, rritjen e cilësisë së dokumentimit dhe forcimin e sigurisë juridike.

"Një praktikë e unifikuar përmbarimore garanton ligjshmëri, siguri juridike dhe trajtim të barabartë të qytetarëve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë."

MIRATOI

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I PËRMBARIMIT

ERGYS QIRICI

Punoi: Grupi i Punës i ngritur me Urdhër nr. 621 Prot., nr. 56, datë 17.04.2026 të ndryshuar, të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit për hartimin dhe unifikimin e akteve përmbarimore të shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

Kryetar i Grupit të Punës:	**Entela TOÇI –** Drejtor i Inspektimit
Anëtar:	**Lorena XHYMERTI –** Përmbarues gjyqësor në Zyrën Përmbarimore Tiranë
Anëtar:	**Pjetër CAKA -** Kryetar/përmbarues gjyqësor në Zyrën Përmbarimore Tiranë
Anëtar:	**Mikeda CENAJ** - Përmbarues gjyqësor në Zyrën Përmbarimore Tiranë
Anëtar:	**Olta SHKËMBI** - Kryetar/përmbarues gjyqësor në Zyrën Përmbarimore Korçë
Anëtar:	**Fitim KOÇIAJ** - Kryetar/përmbarues gjyqësor në Zyrën Përmbarimore Vlorë
Anëtar:	**Vangjel KOSTA** - Pedagog, Lektor në Shkollën e Magjistraturës
Anëtar:	**Ines SPAHIU -** Specialist, Sektori i Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Fushën Civile.

1.1 QËLLIMI I MANUALIT

Ky manual është hartuar me qëllim:

- ✓ unifikimin e formës dhe përmbajtjes së akteve procedurale dhe administrative të përdorura nga përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë;
- ✓ garantimin e një praktike të njëjtë përmbarimore në të gjitha zyrat përmbarimore vendore;
- ✓ sigurimin e një interpretimi dhe zbatimi të njëtrajtshëm të legjislacionit procedural;
- ✓ përmirësimin e cilësisë së dokumentimit të veprimtarisë përmbarimore;
- ✓ lehtësimin e veprimtarisë së përditshme të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë;
- ✓ rritjen e transparencës, efikasitetit dhe gjurmueshmërisë së veprimeve përmbarimore.

Manuali synon gjithashtu të shërbejë si një instrument referues për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, kryetarët e zyrave përmbarimore vendore, Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit, si dhe për strukturat e tjera që bashkëpunojnë me Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.

1.2 STATUSI JURIDIK I MANUALIT

Ky manual përbën një dokument metodologjik dhe orientues, i hartuar në mbështetje të kompetencave ligjore të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit për sigurimin e zbatimit uniform të legjislacionit dhe praktikave përmbarimore.

Mbështetur në nenin 8 të Ligjit nr. 8/2023, Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit:

- siguron unifikimin e kuptimit dhe zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore;
- siguron unifikimin e praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit;
- përgatit dhe nxjerr urdhra, udhëzime dhe metodika për garantimin e kuptimit dhe zbatimit uniform të ligjit.

Gjithashtu, sipas Rregullores së Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, Drejtoria e Inspektimit ka ndër funksionet e saj sugjerimin e standardizimit të praktikave përmbarimore dhe paraqitjen e mendimeve për mënyrën e unifikimit të tyre.

Modelet e përfshira në këtë manual nuk zëvendësojnë dispozitat e:

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Kodit të Procedurës Civile;
- Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”;
- akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit.

Në rast mospërputhjeje midis përmbajtjes së këtij manuali dhe legjislacionit në fuqi, zbatohen drejtpërdrejt dispozitat ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Modelet e akteve të përfshira në këtë manual nuk kanë karakter shterues. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e çështjes konkrete, mund të hartojë dhe përdorë edhe akte të tjera procedurale ose administrative që nuk janë parashikuar në këtë manual. Mungesa e një modeli të caktuar në këtë manual nuk kufizon ushtrimin e kompetencave ligjore të përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

Në bazë të nenit 21 pika ç) të Ligjit nr. 8/2023, përmbaruesi gjyqësor ka detyrimin ligjor të njoftoj dhe sqaroj palën kreditore dhe debitore mbi të gjitha procedurat përmbarimore.

1.3 METODOLOGJIA E PËRDORIMIT TË MANUALIT

Ky manual është organizuar sipas rrjedhës logjike të procedurës përmbarimore, duke ndjekur etapat kryesore të ekzekutimit të titujve ekzekutivë.

Për secilin akt të unifikuar paraqiten:

a. Qëllimi i aktit

Përcakton funksionin procedural ose administrativ që përmbush akti përkatës.

b. Baza ligjore

Përmban referencat kryesore ligjore mbi të cilat mbështetet hartimi dhe përdorimi i aktit.

c. Rastet e përdorimit

Përcakton situatat procedurale kur akti duhet të përdoret nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror.

d. Udhëzimet e plotësimit

Përmban sqarime praktike mbi elementët që duhet të plotësohen dhe mënyrën e hartimit të aktit.

e. Modeli i unifikuar

Përmban tekstin standard të miratuar për përdorim në të gjitha zyrat përmbarimore vendore.

Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë dhe kryetarët e zyrave përmbarimore vendore duhet t'i përdorin modelet e këtij manuali si standard referues në veprimtarinë e tyre të përditshme, duke bërë vetëm përshtatjet e nevojshme sipas rrethanave konkrete të çështjes dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Ky manual duhet të lexohet dhe të zbatohet në harmoni me urdhrat, udhëzimet, metodikat e punës dhe aktet e tjera administrative të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.

PJESA II

FILLIMI I PROCEDURËS PËRMBARIMORE

PRANIMI DHE REGJISTRIMI I KËRKESËS

Pranimi dhe regjistrimi i kërkesës për vënie në ekzekutim përbën fazën e parë të procedurës përmbarimore.

Në këtë fazë dallohen qartë kompetencat administrative të Kryetarit të Zyrës Përmbarimore nga kompetencat procedurale të Përmbaruesit Gjyqësor Shtetëror.

Sipas nenit 515 të Kodit të Procedurës Civile, vënia në ekzekutim e urdhrit të ekzekutimit bëhet nga përmbaruesi gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit dhe dokumentacionit përkatës. Kur dokumentacioni nuk është i plotë ose nuk përmbush kërkesat ligjore, përmbaruesi i jep kreditorit afat 5-ditor për plotësimin e mangësive dhe, në rast mosplotësimi, dokumentacioni i kthehet kërkuesit.

Nga ana tjetër, Kryetari i Zyrës Përmbarimore ushtron kompetencat administrative të organizimit, regjistrimit, dokumentimit dhe shpërndarjes së çështjeve.

Para regjistrimit të çështjes, Kryetari i Zyrës Përmbarimore verifikon dokumentacionin bazë të nevojshëm për regjistrimin e kërkesës. Kur konstatohen mungesa të dokumenteve bazë, kërkuesi njoftohet për plotësimin e tyre dhe i lihet një afat deri në 5 ditë pune. Gjatë kësaj periudhe kërkesa mbahet në trajtim paraprak dhe nuk regjistrohet. Nëse dokumentacioni plotësohet brenda afatit, kërkesa regjistrohet dhe procedohet sipas rregullave të shpërndarjes së çështjeve. Në të kundërt, Kryetari nuk nxjerr urdhër regjistrimi dhe ia kthen dokumentacionin kërkuesit.

Sipas Rregullores së Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, Kryetari regjistron çështjet e reja përmbarimore pas verifikimit të plotësimit të kritereve të përcaktuara në nenin 515 të KPC-së dhe i shpërndan ato me short në mënyrë proporcionale ndërmjet përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë.

Kompetencat e Kryetarit të Zyrës Përmbarimore

Kryetari i Zyrës:

- Nëpërmjet sektorit përgjegjës protokollon kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga kreditori për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv;
- kryen kontrollin paraprak administrativ të dokumentacionit;
- në rast se konstaton mangësi në dokumentacion, kërkon plotësimin e tyre brenda një afati 5 ditor.
- Në rast se nga kërkuesi nuk plotësohen mangësitë, Kryetari nuk nxjerr urdhër regjistrimi dhe ia kthen dokumentacionit kërkuesit.
- Në rastet kur dokumentacioni është i plotë, regjistron çështjen përmbarimore në regjistrat përmbarimorë dhe në sistemin elektronik ALBIS;
- shpërndan çështjen te përmbaruesi gjyqësor i caktuar për ekzekutim me short;

- nxjerr urdhrin e regjistrimit të çështjes përmbarimore;
- ngarkon përmbaruesin gjyqësor me verifikimin përfundimtar të dokumentacionit në përputhje me nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile.

Kompetencat e Përmbaruesit Gjyqësor Shtetëror

Pas shpërndarjes së dosjes:

- verifikon ligjshmërinë procedurale të dokumentacionit;
- kontrollon nëse dokumentet plotësojnë kërkesat e nenit 515 të KPC-së;
- konstaton mangësitë procedurale ose materiale;
- kërkon plotësimin e dokumentacionit;
- vendos kthimin e dokumentacionit kur mangësitë nuk plotësohen brenda afatit ligjor;
- në rastet kur dokumentacioni është konform nenit 515 të KPC, fillon procedurën e ekzekutimit vullnetar dhe më pas ekzekutimin e detyrueshëm.

Veprimi	Kryetari i Zyrës	Përmbaruesi i caktuar
Pranimi i dokumentacionit	✓	
Verifikimi formal i dokumenteve për regjistrim	✓	
Kërkesë për plotësim dokumentacioni	✓	
Kthim i dokumentacionit pa urdhër regjistrimi	✓	
Regjistrimi në ALBIS dhe regjistrat themeltarë	✓	
Shpërndarja e çështjes	✓	
Verifikimi procedural sipas nenit 515 KPC		✓
Kërkesa për plotësim dokumentacioni		✓
Vendimi për kthimin e dokumentacionit		✓
Fillimi i procedurës së ekzekutimit		✓

Parim i përgjithshëm

Neni 515 të KPC-së ia njeh përmbaruesit kompetencën për plotësimin e mangësive dhe kthimin e dokumentacionit, ndërsa neni 62 i Rregullores ia njeh Kryetarit kompetencën për regjistrimin dhe shpërndarjen e çështjeve pas verifikimit formal të kritereve të regjistrimit.

Kryetari regjistron pasi ka verifikuar paraprakisht dokumentacionin nëse është i plotë dhe shpërndan, përmbaruesi verifikon procedurialisht dhe vijon ose jo ekzekutimin.

1. URDHËR REGJISTRIMI

Qëllimi

Urdhri i regjistrimit formalizon marrjen në shqyrtim të kërkesës së kreditorit për ekzekutim dhe hapjen e dosjes përmbarimore. Përmes këtij akti caktohet edhe përmbaruesi gjyqësor që do të ndjekë procedurën, pasi është përzgjedhur me short.

Baza ligjore

- Neni 515 i Kodit të Procedurës Civile;
- Ligji nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror";
- Rregullore

Kur përdoret

Përdoret kur:

- paraqitet kërkesa për ekzekutim;
- është depozituar urdhri i ekzekutimit;
- është paraqitur titulli ekzekutiv;
- është paraqitur dokumentacioni i nevojshëm sipas nenit 515 të KPC-së.

Udhëzime për plotësim

Në urdhër duhet të pasqyrohen:

- kreditori;
- debitori;
- objekti i ekzekutimit;
- titulli ekzekutiv;
- urdhri i ekzekutimit;
- numri i dosjes përmbarimore;
- përmbaruesi gjyqësor i ngarkuar me çështjen.

Përdoret Modeli nr. 1 "Urdhër Regjistrimi".

2. KËRKESË PËR PLOTËSIM DOKUMENTACIONI

Qëllimi

Kërkesa për plotësim dokumentacioni është akt procedural që synon të garantojë se procedura përmbarimore fillon vetëm pasi dokumentacioni i paraqitur nga kreditori të jetë i plotë dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Nëpërmjet këtij akti, përmbaruesi gjyqësor i jep mundësinë kreditorit të plotësojë ose korrigjojë mangësitë e konstatuara përpara vijimit të procedurës së ekzekutimit. Neni 515 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se, kur dokumentet nuk plotësohen sipas kërkesave ligjore, përmbaruesi i lë kërkuesit një afat 5-ditor për plotësimin e mangësive.

Baza ligjore

Neni 515 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite, kur dokumentet e paraqitura për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit nuk janë në rregull, përmbaruesi gjyqësor i lë kërkuesit një afat 5-ditor për plotësimin e mangësive. Në rast mosplotësimi të tyre brenda afatit, dokumentacioni i kthehet kërkuesit.

Kur përdoret

Kërkesa për plotësim dokumentacioni lëshohet nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror i caktuar për ekzekutimin e çështjes, kur gjatë verifikimit procedural të dokumentacionit konstatohen mangësi që pengojnë fillimin e procedurës së ekzekutimit.

Në veçanti përdoret kur mungon ose paraqitet në mënyrë të parregullt:

- titulli ekzekutiv (origjinal ose kopje e noterizuar);
- urdhri i ekzekutimit në origjinal;
- prokura e përfaqësimit, kur kreditori vepron nëpërmjet një përfaqësuesi;
- dokumenti i pagesës së tarifës përmbarimore;
- dokument identifikimi ose dokument legjitimues i personit juridik;
- çdo dokument tjetër i kërkuar nga legjislacioni në fuqi për fillimin e procedurës përmbarimore.

Udhëzime për plotësim

Në kërkesë duhet të evidentohen qartë:

- kreditori ose përfaqësuesi i tij;
- titulli ekzekutiv për të cilin kërkohet ekzekutimi;
- mangësitë konkrete të konstatuara;
- dokumentet që mungojnë ose që duhet të plotësohen;
- afati 5-ditor për plotësimin e mangësive;

- pasojat juridike të mosplotësimit të tyre brenda afatit ligjor, konkretisht kthimi i dokumentacionit.

Modeli standard

Përdoret modeli nr. 3 Ky model hartohet dhe nënshkruhet nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror i caktuar për ekzekutimin e çështjes dhe i njoftohet kreditorit ose përfaqësuesit të tij. Në kërkesë duhet të specifikohen mangësitë e konstatuara, dokumentet që duhet të paraqiten, afati ligjor për plotësimin e tyre dhe pasojat që sjell mosplotësimi i dokumentacionit brenda afatit të caktuar.

Tabelë përmbledhëse

Elementi	**Përmbajtja**
Hartohet nga	Përmbaruesi gjyqësor shtetëror i caktuar për ekzekutim
Baza ligjore	Neni 515 i Kodit të Procedurës Civile
Afati për plotësim	5 ditë
Njoftohet	Kreditori ose përfaqësuesi i tij
Pasoja e mosplotësimit	Kthimi i dokumentacionit
Regjistrohet në dosje	Po

Përdoret Modeli nr. 3 “Kërkesë për plotësim dokumentacioni”

3. VENDIM PËR KTHIMIN E DOKUMENTACIONIT

Qëllimi
Ky vendim formalizon mosfillimin e procedurës së vënies në ekzekutim për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile. Nëpërmjet këtij akti, përmbaruesi gjyqësor konstaton se mangësitë e evidentuara nuk janë plotësuar nga kreditori dhe disponon kthimin e dokumentacionit të paraqitur.

Baza ligjore

Neni 515 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite, kur kërkuesi nuk plotëson mangësitë e dokumentacionit brenda afatit 5-ditor të caktuar nga përmbaruesi gjyqësor, dokumentacioni i kthehet atij.

Kur përdoret
Ky vendim përdoret kur:

- kreditori nuk paraqet dokumentet e kërkuara sipas nenit 515 të Kodit të Procedurës Civile;
- mangësitë e konstatuara nuk plotësohen brenda afatit 5-ditor të përcaktuar në kërkesën për plotësim dokumentacioni;
- dokumentacioni i paraqitur mbetet i paplotë dhe nuk lejon vijimin e procedurës së vënies në ekzekutim.

Udhëzime për plotësim
Vendimi duhet të përmbajë:

- identifikimin e kreditorit ose të përfaqësuesit të tij;
- identifikimin e titullit ekzekutiv dhe urdhrit të ekzekutimit;
- përshkrimin e mangësive të konstatuara;
- referimin e kërkesës paraprake për plotësim dokumentacioni;
- konstatimin se mangësitë nuk janë plotësuar brenda afatit ligjor;
- bazën ligjore mbi të cilën mbështetet vendimi;
- dispozitivin për kthimin e dokumentacionit;
- njoftimin se akti nuk cenon të drejtën e kërkuesit për të ushtruar mjetet juridike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Përdoret modeli nr. 4 "Vendim për Kthimin e Dokumentacionit".

Ky model hartohet dhe nënshkruhet nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror i caktuar për ekzekutimin e çështjes, pasi konstaton se kreditori nuk ka plotësuar mangësitë e evidentuara në "Kërkesën për Plotësim Dokumentacioni për Vënien në Ekzekutim të Titullit Ekzekutiv" brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 515 i Kodit të Procedurës Civile. Përmes këtij akti urdhërohet kthimi i dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi.

PJESA III

EKZEKUTIMI VULLNETAR

Sipas nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesi gjyqësor është i detyruar t'i dërgojë debitorit lajmërimin për ekzekutim vullnetar, duke i caktuar afat:

- 5 ditë kur objekti i ekzekutimit është paga ose detyrimi ushqimor;
- 10 ditë në të gjitha rastet e tjera.

Vetëm pas përfundimit të këtyre afateve dhe në mungesë të ekzekutimit vullnetar mund të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm, përveç rasteve kur ekziston rreziku që ekzekutimi të bëhet i pamundur.

1. LAJMËRIM PËR EKZEKUTIM VULLNETAR TË DETYRIMEVE NË TË HOLLA

Qëllimi

Lajmërimi për ekzekutim vullnetar është akti me të cilin përmbaruesi gjyqësor shtetëror njofton debitorin për fillimin e procedurës përmbarimore dhe i jep mundësinë të përmbushë detyrimin në të holla brenda afatit ligjor, pa qenë e nevojshme ndërmarrja e masave të ekzekutimit të detyrueshëm.

Baza ligjore

- Nenet 517 dhe 518 të Kodit të Procedurës Civile;
- Nenet 128-144 të Kodit të Procedurës Civile mbi mënyrën e njoftimit;
- Ligji nr. 8/2023.

Kur përdoret

Përdoret në të gjitha rastet kur është nxjerrë urdhri i regjistrimit, kur tituli ekzekutiv nuk është masë sigurim padie pasi në këtë rast fillohet direkt në ekzkeutim të detyrueshëm.

Përmbajtja e detyrueshme

Lajmërimi kryhet sipas **modelit nr. 5** dhe duhet të përmbajë:

- të dhënat e kreditorit dhe debitorit;
- përmbledhjen e përmbajtjes së titullit ekzekutiv;
- referencën e urdhrit të ekzekutimit;
- shumën konkrete të detyrimit;
- afatin për ekzekutim vullnetar;
- paralajmërimin për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm;
- detyrimin e debitorit për deklarimin e gjendjes pasurore kur kërkohet nga përmbaruesi.

1.1NJOFTIMI I AKTEVE NË PROCEDURËN PËRMBARIMORE

1.1.1 Parime të përgjithshme

Referuar nenit 517 te Kodit të Procedurës Civile, gjatë procedurës së ekzekutimit të titujve ekzekutivë, përmbaruesi gjyqësor kryen njoftimin e akteve përmbarimore në përputhje me rregullat e parashikuara në Kreun IV "Njoftimet" të Kodit të Procedurës Civile. Rregullat e këtij kreu zbatohen edhe nga përmbaruesit gjyqësorë kur ushtrojnë funksionet e tyre procedurale për njoftimin e akteve.

Qëllimi i njoftimit është sigurimi i dijenisë së palëve për aktet dhe veprimet përmbarimore që prekin të drejtat dhe detyrimet e tyre procedurale.

Përmbaruesi duhet të administrojë në dosjen përmbarimore çdo provë që vërteton kryerjen e rregullt të njoftimit.

1.1.2. Njoftimi shkresor i akteve

(Neni 130 KPC)

Njoftimi shkresor përbën formën kryesore të njoftimit të akteve përmbarimore.

Ai kryhet nëpërmjet:

- dorëzimit të drejtpërdrejtë të aktit nga përmbaruesi;
- dorëzimit nëpërmjet shërbimit postar me dërgesë të porositur.

Për personat juridikë, njoftimi bëhet në qendrën e veprimtarisë së tyre.

Personat juridikë publikë

Njoftimi u dorëzohet:

- titullarit të institucionit; ose
- personave të ngarkuar për pranimin e akteve.

Personat juridikë privatë

Njoftimi u dorëzohet:

- përfaqësuesit ligjor;
- personit të autorizuar për marrjen e akteve;
- në mungesë të tyre, një personi tjetër që punon në qendrën e personit juridik.

Njoftimi nëpërmjet postës

Kur njoftimi kryhet me postë:

- akti dërgohet me dërgesë të porositur;
- dëftesa e marrjes bashkëngjitet dosjes përmbarimore;
- dokumentacioni postar ruhet si provë e njoftimit.

1.1.3. Refuzimi i marrjes së njoftimit

(Neni 130, paragrafi i fundit)

Kur personi:

- refuzon marrjen e aktit;
- nuk di të nënshkruajë;
- nuk mund të nënshkruajë,

përmbaruesi/punonjësi postar bën shënimin përkatës mbi aktin objekt njoftimi.

Kur është e mundur, ky fakt vërtetohet edhe me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm.

Në këto raste, njoftimi konsiderohet i kryer dhe prodhon efektet e tij procedurale.

1.1.4. Njoftimi në vendbanim, vendqëndrim ose vendin e ushtrimit të veprimtarisë

(Neni 131 KPC)

Kur nuk është i mundur njoftimi sipas nenit 130 të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesi e kryen njoftimin në:

- vendbanimin e personit;
- vendqëndrimin e tij;
- zyrën;
- vendin ku ushtron veprimtari tregtare, industriale ose artizanale.

Përmbaruesi duhet të dokumentojë në procesverbal vendin ku është paraqitur dhe veprimet e kryera për identifikimin dhe kontaktimin e personit që njoftohet.

1.1.5. Njoftimi anëtarit të familjes, fqinjit ose portierit

(Neni 131 KPC)

Nëse personi që duhet të njoftohet nuk gjendet në adresën përkatëse, akti mund t'i dorëzohet:

a) Anëtarit të familjes

Një anëtari të familjes që ka mbushur moshën 16 vjeç.

b) Fqinjit

Në mungesë të familjarëve, akti mund t'i dorëzohet një fqinji që pranon t'ia dorëzojë njoftimin personit përkatës.

c) Portierit

Kur nuk është i mundur dorëzimi sipas rasteve të mësipërme, akti mund t'i dorëzohet portierit të ndërtesës ku ndodhet banesa, zyra ose qendra e punës së personit.

Në të gjitha rastet:

- personi që merr aktin duhet të nënshkruajë marrjen;
- përmbaruesi pasqyron identitetin e tij;
- shënon marrëdhënien me personin që njoftohet;
- evidenton veprimet e kryera për gjetjen e adresatit;
- shënon datën, orën dhe vendin e dorëzimit.

1.1.6. Refuzimi i marrjes nga familjarët ose fqinjët

(Neni 132 KPC)

Kur familjari ose fqinji:

- refuzon marrjen e njoftimit;
- nuk di të nënshkruajë;
- nuk mund të nënshkruajë,

përmbaruesi bën shënimin përkatës mbi aktin dhe, kur është e mundur, e vërteton me nënshkrimin e një dëshmitari.

Edhe në këtë rast, njoftimi konsiderohet i kryer.

1.1.7. Njoftimi personit të autorizuar

(Neni 133 KPC)

Çdo person ka të drejtë të caktojë një person të autorizuar për marrjen e njoftimeve.

1.1.8. NJOFTIMI ME SHPALLJE PUBLIKE DHE EKZEKUTIMI NDAJ DEBITORIT QË NUK I DIHET BANIMI

Qëllimi

Njoftimi i rregullt i akteve përmbarimore përbën një garanci themelore procedurale, pasi siguron që debitori të marri dijeni për veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së ekzekutimit. Megjithatë, në praktikë paraqiten raste kur debitori nuk mund të lokalizohet ose kur adresa e tij nuk mund të identifikohet pavarësisht përpjekjeve të kryera nga përmbaruesi gjyqësor.

Për këto raste, Kodi i Procedurës Civile parashikon mekanizma të posaçëm proceduralë, konkretisht:

- njoftimin me shpallje publike (nenet 133/a dhe 133/b);
- emërimin e përfaqësuesit të debitorit kur banimi i tij nuk dihet (neni 522).

Këto dispozita synojnë të krijojnë një balancë ndërmjet të drejtës së debitorit për t'u njoftuar dhe të drejtës së kreditorit për të mos penguar ekzekutimin për shkak të pamundësisë së lokalizimit të debitorit.

Njoftimi me shpallje publike

Natyra juridike

Përmbaruesi gjyqësor nuk mund të kalojë drejtpërdrejt në njoftim me shpallje publike pa provuar më parë se ka shteruar të gjitha mënyrat ligjore të njoftimit.

Kushtet për përdorimin e njoftimit me shpallje publike

Në përputhje me nenin 133/a të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi me shpallje publike mund të përdoret në dy raste:

a) Pamundësia e njoftimit sipas mënyrave të zakonshme

Kur nuk është e mundur të realizohet njoftimi sipas rregullave të parashikuara në nenet 129, 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Procedurës Civile dhe janë marrë të gjitha masat e nevojshme për identifikimin e adresës së personit.

Në këtë rast përmbaruesi duhet të dokumentojë se ka provuar:

- njoftimin personal;
- njoftimin postar;
- njoftimin nëpërmjet e – Albania;
- njoftimin në vendbanim ose vendqëndrim;
- njoftimin familjarit, fqinjit ose portierit;
- njoftimin përfaqësuesit të autorizuar, nëse ekziston.

b) Mungesa e vendbanimit ose përfaqësuesit

Kur personi:

- nuk ka vendbanim;
- nuk ka vendqëndrim;
- nuk ka zgjedhur adresë për njoftim;
- nuk ka caktuar përfaqësues në Republikën e Shqipërisë;

dhe njoftimi nuk ka mundur të kryhet sipas formave të tjera të parashikuara nga ligji.

Veprimet paraprake të përmbaruesit

Përpara se të vlerësohet përdorimi i njoftimit me shpallje publike, përmbaruesi gjyqësor duhet të dokumentojë në dosjen përmbarimore veprimet e ndërmarra për identifikimin dhe gjetjen e debitorit.

Këto veprime mund të përfshijnë:

- verifikimin e adresës së pasqyruar në titullin ekzekutiv;
- verifikimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- verifikimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit për personat juridikë;
- kërkimet në adresat e njohura;
- njoftimet postare të kthyera pa rezultat;
- procesverbalet e mosgjetjes së debitorit.

Mungesa e dokumentimit të këtyre veprimeve mund të sjellë pavlefshmërinë e procedurës së njoftimit.

Procedura e njoftimit me shpallje publike

Personat fizikë

Sipas nenit 133/b të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi me shpallje publike kryhet nëpërmjet afishimit:

- në gjykatën kompetente;
- në vendin ku personi ka pasur vendbanimin;
- në vendin ku personi ka pasur vendqëndrimin;
- në njësinë administrative përkatëse.

Përmbaruesi duhet të sigurojë dokumentacionin provues të afishimit dhe kohëzgjatjes së tij.

Personat juridikë privatë

Kur debitori është person juridik privat, njoftimi kryhet me afishimin e shpalljes në selinë e regjistruar në regjistrat publikë përkatës.

Publikimi elektronik

Përveç afishimit fizik, shpallja publikohet edhe:

- në faqen zyrtare në internet;
- në portalin elektronik kombëtar, nëse ekziston dhe përdoret për këtë qëllim.

Dokumentacioni i publikimit duhet të administrohet në dosjen përmbarimore.

Afati i afishimit

Shpallja publike duhet të qëndrojë e afishuar për jo më pak se 20 ditë.

Përmbaruesi duhet të mbajë dokumentacion që vërteton:

- datën e afishimit;
- vendin e afishimit;
- datën e përfundimit të afishimit;
- publikimin elektronik, kur është kryer.

Njoftimi me shpallje publike bëhet sipas modelit nr. 6.

1.1.9Ekzekutimi ndaj debitorit që nuk i dihet banimi

Kuptimi dhe qëllimi i nenit 522

Neni 522 i Kodit të Procedurës Civile parashikon një mekanizëm të posaçëm procedural për rastet kur përmbaruesi gjyqësor nuk arrin të identifikojë banimin e debitorit.

Kjo dispozitë synon të shmangë bllokimin e procedurës së ekzekutimit për shkak të mungesës së informacionit mbi vendndodhjen e debitorit.

Verifikimet paraprake

Para paraqitjes së kërkesës në gjykatë, përmbaruesi duhet të provojë se ka kryer kërkime të mjaftueshme për identifikimin e debitorit.

Dosja përmbarimore duhet të përmbajë:

- procesverbalet e kërkimeve;
- dokumentacionin e kthyer nga posta;

- verifikimet në regjistrat publikë;
- informacionet e marra nga institucionet shtetërore;
- çdo dokument tjetër që provon pamundësinë e identifikimit të adresës së debitorit.

Kërkesapër emërimin e përfaqësuesit

Kur banimi i debitorit nuk dihet, përmbaruesi gjyqësor i drejtohet me kërkesë gjykatës së shkallës së parë të vendit të ekzekutimit.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- identitetin e palëve;
- të dhënat e titullit ekzekutiv;
- veprimet e kryera për kërkimin e debitorit;
- provat që vërtetojnë pamundësinë e gjetjes së tij;
- kërkimin për emërimin e përfaqësuesit sipas nenit 522 të Kodit të Procedurës Civile.

Emërimi i përfaqësuesit nga gjykata

Pasi shqyrton kërkesën dhe verifikon rrethanat e paraqitura, gjykata emëron një përfaqësues të debitorit brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Përfaqësuesi vepron për mbrojtjen e interesave procedurale të debitorit gjatë procedurës së ekzekutimit.

Udhëzim praktik për përmbaruesin

Në rast se debitori nuk gjendet:

1. Kryhen të gjitha format e njoftimit të parashikuara nga ligji.
2. Dokumentohen çdo veprim dhe çdo tentativë njoftimi.
3. Verifikohen të gjitha adresat e mundshme të debitorit.
4. Nëse plotësohen kushtet e nenit 133/a, procedohet me njoftim me shpallje publike.
5. Nëse banimi i debitorit mbetet i panjohur, paraqitet kërkesë në gjykatë sipas nenit 522 të KPC-së.
6. Pas emërimit të përfaqësuesit nga gjykata, procedura e ekzekutimit vijon me njoftimin e akteve ndaj përfaqësuesit të emëruar.

Në rastet e njoftimit me shpallje publike, publikohen vetëm të dhënat minimale identifikuese të nevojshme për individin që njoftohet. Nuk publikohen numri personal, adresa e plotë e banimit, të dhënat financiare, numrat e llogarive bankare, informacioni mbi personat e tretë apo të dhëna të tjera që nuk janë të domosdoshme për realizimin e njoftimit.

Rastet kur debitori nuk ka adresë të njohur dhe njoftimet lidhen me një pasuri e paluajtshme

Në rastet kur debitori nuk ka vendbanim ose vendqëndrim të njohur dhe nuk është e mundur kryerja e njoftimit sipas mënyrave të parashikuara në nenet 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesi gjyqësor, përpara kryerjes së veprimeve përmbarimore që prekin drejtpërdrejt të drejtat reale mbi një pasuri të paluajtshme, vlerësohet që me qëllim moscënimin e interesave të debitorit, përmbaruesi t'i drejtohet gjykatës kompetente për emërimin e një përfaqësuesi të debitorit sipas nenit 522 të Kodit të Procedurës Civile.

Kjo zgjedhje të kryhet për veprimet që lidhen me:

- lirimin dhe dorëzimin e sendit të paluajtshëm;
- kthimin e sendit të paluajtshëm;
- njoftimin e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme;
- nxjerrjen e pasurisë së paluajtshme në ankand;
- shpalljen e ankandit;
- shitjen me ankand të pasurisë së paluajtshme;
- kalimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme;
- çdo veprim tjetër përmbarimor që mund të sjellë humbjen e posedimit ose të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme.

Megjithëse nenet 133/a dhe 133/b të Kodit të Procedurës Civile nuk përjashtojnë shprehimisht përdorimin e njoftimit me shpallje publike për këto kategori aktesh, për shkak të natyrës dhe pasojave të tyre mbi të drejtat pasurore të debitorit, përmbaruesi gjyqësor, në zbatim të nenit 522 të Kodit të Procedurës Civile, kërkon emërimin e një përfaqësuesi të debitorit me qëllim garantimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes dhe ushtrimin e mjeteve procedurale të parashikuara nga ligji.

Pas emërimit nga gjykata, aktet dhe veprimet procedurale të mësipërme i njoftohen përfaqësuesit të debitorit, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit.

Kërkesa për përcaktim përfaqësuesi ligjor bëhet sipas modelit nr. 7

1.1.9. NJOFTIMI ELEKTRONIK

(Neni 141 KPC)

Njoftimi elektronik kryhet nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik në adresat e kontaktit të personit që njoftohet.

Për çdo njoftim elektronik përmbaruesi harton procesverbal, në të cilin shënohen:

- adresa elektronike ose të dhënat e kontaktit;

- mjeti i përdorur për komunikim;
- data dhe ora e komunikimit;
- personi me të cilin është komunikuar;
- qëllimi i njoftimit.

Procesverbali bëhet pjesë e dosjes përmbarimore.

1.1.10. Mënyra të tjera të njoftimit

(Neni 144 KPC)

Njoftimi mund të kryhet edhe me çdo mënyrë tjetër që garanton marrjen efektive të njoftimit, për sa kohë që personi konfirmon personalisht me shkrim se e ka marrë atë.

1.1.11. Dokumentimi i njoftimit

(Neni 138 KPC)

Për çdo njoftim të kryer nga përmbaruesi duhet të mbahet procesverbal ose dokumentacion tjetër provues, ku pasqyrohen detyrimisht:

- vendi i njoftimit;
- data e njoftimit;
- personi që ka marrë aktin;
- lidhja e tij me personin të cilit i drejtohet akti;
- nënshkrimi i personit marrës;
- arsyet që kanë penguar njoftimin, kur ato ekzistojnë.

Dokumentacioni i njoftimit administrohet në dosjen përmbarimore dhe përbën provën e kryerjes së rregullt të procedurës së njoftimit.

1.1.12. Debitori me banim të panjohur

(Neni 522 KPC)

Kur banimi ose vendqëndrimi i debitorit nuk dihet dhe nuk bëhet i mundur identifikimi i tij, përmbaruesi gjyqësor paraqet kërkesë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit për emërimin e një përfaqësuesi të debitorit.

Gjykata, pasi verifikon rrethanat e paraqitura, brenda 10 ditëve emëron një përfaqësues të debitorit. Shpërblimi i këtij përfaqësuesi parapaguhet nga kreditori sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile.

2. LAJMËRIM PËR EKZEKUTIM VULLNETAR TË DETYRIMEVE JO NË TË HOLLA

Qëllimi

Ky akt përdoret për njoftimin e debitorit për përmbushjen vullnetare të një detyrimi jo monetar, si:

- dorëzimi i një sendi;
- lirimi i një pasurie;
- përmbushja ose moskryerja e një veprimi të caktuar;
- rikthimi në punë;
- çdo detyrim tjetër jo në të holla.

Baza ligjore

- Nenet 517 dhe 518 të Kodit të Procedurës Civile;

Kur përdoret

Kur titulli ekzekutiv urdhëron:

- dorëzimin e një sendi të caktuar;
- lirimin e një sendi të paluajtshëm;
- kryerjen e një veprimi;
- moskryerjen e një veprimi.

Përmbajtja e detyrueshme

Lajmërimi bëhet sipas nenit 517, 518 të KPC.

Përdoret Modeli nr. 8 “lajmërim për ekzekutim vullnetar I detyrimeve jo në të holla”.

3. DEKLARATA E GJENDJES PASURORE TË DEBITORIT

Qëllimi

Deklarata e gjendjes pasurore i shërben përmbaruesit gjyqësor për identifikimin e burimeve të mundshme të ekzekutimit dhe garantimin e efektivitetit të procedurës përmbarimore.

Baza ligjore

Neni 517, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Civile.

Detyrimi për deklarim

Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar dhe kur kërkohet nga përmbaruesi gjyqësor, debitori detyrohet të deklarojë me shkrim:

- të ardhurat personale;
- llogaritë bankare;
- pasuritë e luajtshme;
- pasuritë e paluajtshme;
- kreditë dhe detyrimet ndaj personave të tretë;
- kreditë që persona të tretë i detyrohen atij;
- çdo pasuri tjetër që mund t'i nënshtrohet ekzekutimit.

Rëndësia procedurale

Deklarata:

- administrohet në dosjen përmbarimore;
- përdoret për orientimin e veprimeve të ekzekutimit;
- nuk kufizon të drejtën e përmbaruesit për të kryer verifikime të mëtejshme në regjistra publikë ose pranë institucioneve shtetërore.

Pasojat e mosdeklarimit

Mosdeklarimi, deklarimi i paplotë ose deklarimi i rremë mund të sjellë përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi dhe të shërbejë si bazë për ndërmarrjen e veprimeve të tjera procedurale në funksion të ekzekutimit.

Deklarata bëhet sipas modelit nr. 9

PJESA IV

EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM

Kuptimi dhe fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm

Ekzekutimi i detyrueshëm përbën fazën procedurale në të cilën përmbaruesi gjyqësor kalon nga kërkesa për përmbushje vullnetare e detyrimit në përdorimin e mjeteve ligjore të detyrimit për realizimin e titullit ekzekutiv.

Sipas nenit 519 të Kodit të Procedurës Civile, ekzekutimi i detyrueshëm mund të fillojë vetëm pasi të kenë kaluar afatet e parashikuara në nenin 517 të KPC-së për ekzekutimin vullnetar, konkretisht:

- 5 ditë për pagën dhe detyrimet ushqimore;
- 10 ditë për të gjitha detyrimet e tjera.

Vetëm pas kalimit të këtyre afateve dhe në mungesë të përmbushjes së detyrimit nga debitori, përmbaruesi gjyqësor disponon fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Përjashtimi: Fillimi i menjëhershëm i ekzekutimit

Paragrafi i dytë i nenit 519 të Kodit të Procedurës Civile parashikon një procedurë të posaçme.

Kur ekziston rreziku se pritja e afatit të ekzekutimit vullnetar mund të bëjë të pamundur ose dukshëm më të vështirë realizimin e ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor mund të fillojë menjëherë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm pa pritur mbarimin e afatit të njoftimit për ekzekutim vullnetar.

Rrethana që mund të justifikojnë fillimin e menjëhershëm

Në praktikë, ky rrezik mund të rezultojë vetëm me kërkesë të palës kreditore kur:

- debitori po transferon pasuritë e tij;
- po kryhen veprime për shitjen ose fshehjen e pasurive;
- ekziston rrezik i largimit jashtë shtetit;
- ekziston rrezik i largimit ose zhvendosjes së mjeteve motorike;
- pasuria objekt ekzekutimi po tjetërsohet;
- sendet objekt ekzekutimi janë të prishshme ose lehtësisht të humbshme;
- dokumentacioni i administruar tregon qartë tentativën e shmangies së ekzekutimit.

Në këto raste përmbaruesi duhet të arsyetojë konkretisht ekzistencën e rrezikut në aktin procedural përkatës, si dhe të bashkëlidhi dokumentacionin provues.

1. VENDIM PËR FILLIMIN E EKZEKUTIMIT TË DETYRUESHËM

Qëllimi

Ky vendim formalizon kalimin nga faza e ekzekutimit vullnetar në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

Ai dokumenton:

- kalimin e afatit të ekzekutimit vullnetar;
- mosplotësimin e detyrimit nga debitori;
- bazën ligjore për ndërmarrjen e masave të ekzekutimit.

Baza ligjore

- Neni 517 i KPC-së;
- Neni 519 i KPC-së;
- Neni 515 i KPC-së;

Kur përdoret

Kur:

- debitori është njoftuar rregullisht;
- ka kaluar afati ligjor;
- detyrimi nuk është përmbushur;
- nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për vijimin e procedurës.

Formati i vendimit për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm është sipas modelit nr. 10.

2. VENDIM PËR FILLIMIN E MENJËHERSHËM TË EKZEKUTIMIT TË DETYRUESHËM

Qëllimi

Ky akt përdoret me kërkesë të kreditorit kur ekziston rreziku që pritja e afatit të ekzekutimit vullnetar ta bëjë ekzekutimin të pamundur ose tepër të vështirë.

Baza ligjore

- Neni 519 paragrafi i dytë i KPC-së.

Kur përdoret

Kur me kërkeë të kreditorit, përmbaruesi disponon prova ose indicie serioze se:

- debitori po shmang ekzekutimin;
- po transferon pasuri;
- po fsheh pasurinë;
- po ndryshon vendndodhje;
- po kryen veprime që cenojnë efektivitetin e ekzekutimit.
- titulli ekzekutiv është një masë sigurim padie sipas nenit 515 të KPC

Kërkesa për arsyetim

Vendimi duhet të përmbajë:

- faktet konkrete;
- dokumentet mbështetëse;
- analizën e rrezikut;
- arsyet pse nuk mund të pritet afati i nenit 517.

Formati i vendimit për fillimin menjëherë të ekzekutimit të detyrueshëm është sipas modelit nr. 11.

3. PROCESVERBALI I VEPRIMEVE PËRMBARIMORE

Qëllimi

Procesverbali është dokumenti bazë procedural që provon kryerjen e çdo veprimi përmbarimor dhe garanton gjurmueshmërinë e procedurës.

Përmbaruesi është i detyruar të mbajë procesverbal për çdo veprim procedural të kryer gjatë ekzekutimit.

Baza ligjore

- Neni 524 i Kodit të Procedurës Civile.

Parimi i përgjithshëm

Nuk duhet të kryhet asnjë veprim përmbarimor pa administrimin e procesverbalit përkatës në dosjen përmbarimore.

Procesverbali përbën provën kryesore të:

- ekzistencës së veprimit;
- mënyrës së kryerjes së tij;
- personave të pranishëm;
- kundërshtimeve eventuale.

Përmbajtja e detyrueshme sipas nenit 524 KPC

Procesverbali duhet të përmbajë të paktën:

1. Datën e veprimit;
2. Vendin e veprimit;
3. Të dhënat e përmbaruesit;
4. Të dhënat e personave të pranishëm;
5. Kërkesat e paraqitura nga palët;
6. Deklarimet e palëve;
7. Përshkrimin e veprimit të kryer;
8. Sendet e marra;
9. Shumat e arkëtuara;
10. Shpenzimet procedurale;
11. Kundërshtimet e palëve;
12. Nënshkrimet e pjesëmarrësve.

Veprimet për të cilat mbahet procesverbal

Procesverbal duhet të mbahet veçanërisht për:

- inventarizimin;
- sekuestron;
- lirimin e pasurisë;
- dorëzimin e sendeve;
- vendosjen në posedim;
- ankandin;
- arkëtimin e shumave;
- shpërndarjen e shumave;
- çdo veprim tjetër të kryer në terren.

Formati i procesverbalit është sipas modelit nr. 12, duke u përshtatur sipas objektit të veprimit përmbarimor përkatës që do të pasqyrohet në procesverbal.

PJESA V

Kapitulli I

1. Qëllimi i sekuestros

Sekuestroja përbën veprimin e parë përmbarimor që ndërmerret në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve në të holla. Qëllimi i saj është sigurimi i pasurisë së debitorit për të garantuar realizimin e të drejtës së kreditorit të njohur me titull ekzekutiv.

Nëpërmjet vendosjes së sekuestros, përmbaruesi gjyqësor siguron që pasuritë e debitorit të ruhen dhe të mos tjetërsohen, fshehen, dëmtohen apo zhduken deri në shlyerjen e detyrimit ose realizimin e procedurës së shitjes së tyre sipas ligjit.

Sipas nenit 527 të Kodit të Procedurës Civile, kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbaruesi gjyqësor fillon ekzekutimin e detyrueshëm duke vendosur sekuestro mbi kreditë, sendet e luajtshme dhe sendet e paluajtshme të debitorit, në masën e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

2. Baza ligjore

Baza ligjore e sekuestros parashikohet në nenet 527-531 të Kodit të Procedurës Civile.

Në mënyrë të veçantë:

- Neni 527 rregullon vendosjen e sekuestros.
- Neni 528 rregullon të drejtën e debitorit për të propozuar pasuri të tjera mbi të cilat mund të vendoset sekuestro.
- Neni 529 përcakton pasuritë e përjashtuara nga sekuestrimi.
- Neni 530 rregullon shtrirjen e sekuestros mbi shpërblimin nga sigurimi.
- Neni 531 përcakton efektet juridike dhe detyrimet e debitorit pas vendosjes së sekuestros.

3. Shtrirja e sekuestros

Sekuestroja mund të shtrihet mbi:

- kreditë e debitorit;
- sendet e luajtshme;
- sendet e paluajtshme;
- llogaritë bankare;
- pagën dhe të ardhurat e debitorit;
- të drejtat pasurore që personat e tretë i detyrohen debitorit;
- pasuri të tjera të sekuestrueshme sipas ligjit.

Sipas nenit 528 të KPC-së, me kërkesën e debitorit, përmbaruesi mund të vendosë sekuestro mbi një pasuri tjetër nga ajo që ka treguar kreditori, kur çmon se ajo është e mjaftueshme për plotësimin e kërkesës së kreditorit.

4. Pasuritë mbi të cilat nuk mund të vendoset sekuestro

Neni 529 i Kodit të Procedurës Civile parashikon kategoritë e pasurive të përjashtuara nga sekuestrimi.

Përmbaruesi gjyqësor duhet të verifikojë me kujdes që pasuria objekt sekuestrimi të mos përfshihet në kategoritë e përjashtuara nga ligji.

5. Efektet juridike të vendosjes së sekuestros

Nga momenti i vendosjes së sekuestros lindin kufizime ligjore për debitorin dhe për çdo person që mban në posedim pasurinë e sekuestruar.

Sipas nenit 531 të KPC-së:

- debitori nuk mund të disponojë pasurinë e sekuestruar;
- debitori nuk mund ta shesë, dhurojë, tjetërsojë apo ngarkojë me barrë pasurinë;
- debitori nuk mund ta dëmtojë ose ta zhdukë pasurinë e sekuestruar;
- e njëjta ndalesë shtrihet edhe ndaj personave të tretë që e kanë në posedim pasurinë e debitorit.

Mosrespektimi i këtyre detyrimeve sjell përgjegjësi sipas dispozitave të Kodit Penal.

6. Sekuestroja mbi shpërblimin nga sigurimi

Sipas nenit 530 të KPC-së, nëse pasuria e sekuestruar është e siguruar, sekuestrimi nuk kufizohet vetëm mbi sendin, por shtrihet edhe mbi çdo shpërblim që rrjedh nga kontrata e sigurimit.

Kjo do të thotë se në rast humbjeje, dëmtimi apo shkatërrimi të sendit të siguruar, kreditori ruan të drejtën që ekzekutimi të vazhdojë mbi shumën e sigurimit që i takon debitorit.

Përmbaruesi gjyqësor duhet të evidentojë ekzistencën e kontratës së sigurimit dhe të njoftojë subjektin sigurues kur kjo është e nevojshme për realizimin e ekzekutimit.

KAPITULLI II

SEKUESTRO MBI KREDITË E DEBITORIT DHE PASURITË QË PERSONAT E TRETË I DETYROHEN DEBITORIT

Qëllimi

Ky lloj ekzekutimi zbatohet kur debitori ka kredi, të drejta pasurore ose sende që mbahen nga persona të tretë. Qëllimi është që këto pasuri të mos i dorëzohen debitorit, por të vihen në dispozicion të procedurës përmbarimore për realizimin e detyrimit në favor të kreditorit. Baza ligjore e kësaj procedure parashikohet në nenet 581-586 të Kodit të Procedurës Civile.

1. Deklarimi i pasurive të debitorit

Përpara vendosjes së sekuestros, përmbaruesi gjyqësor duhet të sigurohet për ekzistencën e kredive të debitorit dhe të sendeve që personat e tretë i detyrohen ose i mbajnë për llogari të tij. Për këtë qëllim, përmbaruesi njofton me shkresë debitorin dhe personin e tretë.

Pas marrjes së njoftimit, debitori ka detyrimin të deklarojë se informacioni mbi pasuritë e tij ose mbi pasuritë e lëna në posedim të personave të tretë është i saktë dhe i plotë. Kur debitori është person juridik, deklarimi kryhet nga përfaqësuesi ligjor ose personi i autorizuar sipas ligjit apo statutit.

Dhënia e një deklarimi të rremë passjell përgjegjësi sipas nenit 320 të Kodit Penal.

Përdoret modeli nr. 13 “Kërkesë për deklarimin e pasurisë, drejtuar personit të tretë”.

Udhëzim praktik

Përmbaruesi duhet të kërkojë deklarimin e pasurisë sa 28roc që ekzistojnë indicie se debitori ka kredi të pambledhura, të ardhura, kontrata, pagesa të pritshme ose sende të administruara nga persona të tretë.

2. Verifikimi i ekzistencës së kredive

Përpara vendosjes së sekuestros në kreditë e debitorit, përmbaruesi gjyqësor duhet të verifikojë ekzistencën e kredive ose sendeve që personat e tretë I detyrohen debitorit. Ky verifikim kryhet në bazë të dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve të siguruara kryesisht nga vetë përmbaruesi.

Verifikimi mund të mbështetet në:

- kontrata të paraqitura nga kreditori;
- deklarime të debitorit;
- informacion nga persona të tretë;

- dokumentacion financiar apo tregtar;
- regjistra publikë dhe burime të tjera të ligjshme informacioni.

Vetëm pas krijimit të bindjes për ekzistencën e kredisë ose sendit mund të procedohet me vendosjen e sekuestros.

3. Njoftimi i personit të tretë

Pasi konstaton ekzistencën e kredisë ose sendit, përmbaruesi I dërgon personit të tretë njoftimin për vendosjen e sekuestros. Me marrjen e këtij njoftimi, personi I tretë ndalohet t'ia dorëzojë debitorit kredinë, shumat monetare ose sendet që mban për llogari të tij.

Njoftimi duhet të përmbajë:

- identifikimin e çështjes përmbarimore;
- identifikimin e debitorit;
- përcaktimin e kredisë ose sendit objekt sekuestrimi;
- afatin ligjor për përgjigje;
- paralajmërimin për pasojat ligjore në rast mosbashkëpunimi.

Ky moment përbën pikën e fillimit të efekteve të sekuestros ndaj personit të tretë.

Përdoret modeli nr. 14 "Njoftim personit të tretë i vendosjes së sekuestros" .

4. Kundërshtimi i personit të tretë

Sipas nenit 583 të KPC-së, personi I tretë është I detyruar të përgjigjet brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të sekuestrimit.

Në përgjigjen e tij ai deklaron:

a) nëse pranon se kredia ose sendet janë të debitorit dhe nëse është gati t'I dorëzojë ato;

b) nëse mbi to pretendojnë të drejta edhe persona të tjerë;

c) nëse mbi të njëjtën kredi ose sende është vendosur sekuestro në bazë të një urdhri tjetër ekzekutimi.

Efektet e kundërshtimit

Kur personi I tretë kundërshton ekzistencën e kredisë ose pretendon se sendi nuk I përket debitorit, ekzekutimi nuk mund të vazhdojë mbi atë pasuri. Në këtë rast kreditori duhet të ngrejë padi për të provuar se kredia ose sendi janë të debitorit të tij.

5. Dorëzimi i kredive dhe sendeve të sekuestruara

Kur personi i tretë nuk kundërshton dhe pranon se kredia ose sendi i përket debitorit, ai është i detyruar t'ia dorëzojë këto përmbaruesit gjyqësor.

Shumat monetare të realizuara nga ekzekutimi derdhen në llogarinë e zyrës së përmbarimit dhe më pas përdoren sipas procedurës së ekzekutimit për shlyerjen e detyrimit.

Dorëzimi duhet të dokumentohet me procesverbal, në të cilin evidentohen:

- identiteti i personit të tretë;
- përshkrimi i kredisë ose sendit;
- data e dorëzimit;
- vlera e pasurisë së dorëzuar;
- nënshkrimet e personave pjesëmarrës.

Përdoren modelet nr. 15 dhe 17.

7. Kreditë e siguruara me peng ose hipotekë

Kur kredia e sekuestruar është e siguruar me peng, personi që mban sendin e lënë peng nuk mund t'ia dorëzojë atë askujt pa urdhrin e përmbaruesit gjyqësor.

Kur kredia është e siguruar me hipotekë, përmbaruesi duhet të sigurojë që në regjistrat e pasurive të paluajtshme të bëhet shënimi për vendosjen e sekuestros.

Kapitulli III

Sekuestro mbi Pagën dhe të Ardhurat e Debitorit

Qëllimi

Sekuestroja mbi pagën dhe të ardhurat e debitorit përbën një nga format më të zakonshme të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve në të holla. Nëpërmjet kësaj procedure, përmbaruesi gjyqësor realizon detyrimin duke urdhëruar punëdhënësin të mbajë periodikisht pjesën e sekuestrueshme të pagës ose të ardhurave të debitorit dhe ta transferojë atë sipas procedurës përmbarimore. Kjo formë ekzekutimi rregullohet nga nenet 533, 587 dhe 588 të Kodit të Procedurës Civile.

1. Sekuestroja e pagës

Sipas nenit 533 të Kodit të Procedurës Civile, pas zbritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe taksave mbi të ardhurat, përmbaruesi gjyqësor mund të vendosë sekuestro mbi pagën e debitorit.

Sekuestroja e pagës mund të vendoset vetëm pas:

- regjistrimit të çështjes përmbarimore;
- njoftimit për ekzekutim vullnetar;
- fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm sipas nenit 519 të KPC-së;
- identifikimit të marrëdhënies së punës së debitorit.

Përmbaruesi gjyqësor i drejton punëdhënësit urdhrin për sekuestrimin e pagës, duke përcaktuar detyrimin, masën e sekuestrimit dhe detyrimet e punëdhënësit për zbatimin e tij.

2. Respektimi i minimumit jetik

Neni 533 i Kodit të Procedurës Civile parashikon shprehimisht se sekuestrimi i pagës nuk mund të cenojë minimumin jetik të debitorit, i cili përcaktohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Për këtë arsye, përmbaruesi gjyqësor duhet të verifikojë në çdo rast:

- vlerën neto të pagës;
- kufijtë ligjorë të lejueshëm të sekuestrimit;
- kategorinë e detyrimit që po ekzekutohet.

Sekuestrimi nuk duhet të vendosë debitorin në kushte që i pamundësojnë sigurimin e nevojave minimale të jetesës.

3. Shtrirja e sekuestros mbi shpërblime të tjera

Sipas nenit 587 të Kodit të Procedurës Civile, sekuestroja nuk kufizohet vetëm në pagën e treguar në urdhrin fillestar të sekuestrimit. Ajo shtrihet edhe mbi çdo shpërblim ose të ardhur tjetër që debitori përfiton nga e njëjta marrëdhënie pune ose nga një punë tjetër pranë të njëjtit punëdhënës.

Në këtë kategori përfshihen, sipas rastit:

- paga mujore;
- shpërblimet periodike;
- bonuset;
- pagesat shtesë;
- të ardhurat e tjera që burojnë nga marrëdhënia e punës.

Përmbaruesi nuk ka nevojë të nxjerrë urdhër të ri për çdo shpërblim të veçantë, pasi efekti i sekuestros shtrihet automatikisht mbi këto të ardhura sipas nenit 587 të KPC-së.

4. Ndryshimi i vendit të punës së debitorit

Neni 587 i KPC-së rregullon edhe rastin kur debitori ndryshon vendin e punës. Në këtë situatë:

- lajmërimi i sekuestrimit i përcillet punëdhënësit të ri nga punëdhënësi ku debitori ka qenë i punësuar më parë;

- lajmërimi konsiderohet sikur është dërguar drejtpërdrejt nga përmbaruesi gjyqësor;
- punëdhënësi i mëparshëm është i detyruar të njoftojë përmbaruesin gjyqësor për kalimin e debitorit në një punë tjetër.

E njëjta detyrë njoftimi ekziston edhe kur debitori largohet ose pushohet nga puna. Njoftimi duhet të bëhet brenda 5 ditëve.

5. Përgjegjësia e punëdhënësit

Neni 588 i Kodit të Procedurës Civile parashikon përgjegjësinë e personit kompetent në qendrën e punës kur:

- nuk bën ndalesat nga paga sipas urdhrit të përmbaruesit;
- nuk njofton për kalimin e debitorit në një punë tjetër;
- nuk njofton për pushimin e debitorit nga puna.

Në këto raste, përmbaruesi gjyqësor mund të vendosë gjobë deri në 30.000 lekë.

Përdoret Modeli nr. 20 "Urdhër për vendosjen e sekuestros në pagën e debitorit".

Përdoret Modeli nr. 21 "Njoftim punëdhënësit për zbatimin e sekuestros mbi pagën".

Përdoret Modeli nr. 22 "Vendim për gjobitjen e punëdhënësit".

Përdoret Modeli nr. 22.1 "Kërkesë për informacion drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve".

Kapitulli IV

Sekuestro mbi Shumat në Llogaritë Bankare

Ky kapitull rregullon procedurën e ekzekutimit mbi shumat e depozituara në llogaritë bankare të debitorit. Baza ligjore kryesore për këtë procedurë gjendet në nenet 593-600 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në Udhëzimin nr, 2, datë 27.03.2014 "Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë" të Bankës së Shqipërisë, i nxjerrë në zbatim të nenit 600 të KPC-së.

Sipas nenit 593 të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesi gjyqësor u drejtohet njëkohësisht të gjitha bankave që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të detyruara të zbatojnë urdhrin e sekuestros dhe të informojnë nëse debitori ka:

- llogari rrjedhëse;
- depozita;
- kredi ose të drejta të tjera bankare në emrin e tij.

Sipas pikës 5.4 të Udhëzimit nr. 2 të Bankës së Shqipërisë, përmbaruesi gjyqësor mund të kërkojë informacion nga banka në çdo kohë për gjendjen e llogarisë mbi të cilën është vendosur sekuestro dhe banka është e detyruar të kthejë përgjigje brenda ditës së nesërme të punës.

Vendosja e sekuestros mbi llogaritë

Vendosja e sekuestros mbi llogaritë bankare kryhet në bazë të nenit 594 të Kodit të Procedurës Civile dhe Udhëzimit nr. 2 të Bankës së Shqipërisë.

Sipas nenit 594 të KPC-së, banka, me marrjen e urdhrit të përmbaruesit gjyqësor, vendos sekuestro mbi:

- llogaritë rrjedhëse;
- depozitat;
- kreditë;
- çdo të drejtë bankare të debitorit,

në masën e nevojshme për realizimin e detyrimit.

Sipas pikës 4.2 të Udhëzimit nr. 2, urdhri për vendosjen e sekuestros duhet të përmbajë minimalisht:

- identifikimin e plotë të debitorit;
- shumën për të cilën vendoset sekuestroja;
- urdhrin e ekzekutimit ose titullin ekzekutiv mbi të cilin mbështetet procedura.

Banka është e detyruar:

- të vendosë sekuestro brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e urdhrit;

- të njoftojë përmbaruesin për vendosjen e sekuestros brenda 3 ditëve pune.

4. Transferimi i shumave të sekuestruara

Pasi banka konfirmon vendosjen e sekuestros, përmbaruesi gjyqësor nxjerr urdhrin për transferimin e shumës së bllokuar.

Sipas nenit 595 të KPC-së:
- shumat e nxjerra nga llogaritë e debitorit kalojnë në llogarinë e kreditorit;
- ose në llogarinë e zyrës së përmbarimit;
- ose në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor sipas rastit.

Sipas pikës 6.1 të Udhëzimit nr. 2, përmbaruesi duhet të dërgojë urdhrin e transferimit jo më vonë se 10 ditë pune nga marrja e njoftimit të bankës se sekuestroja është vendosur.

Përmbajtja e urdhrit të transferimit të shumës

Sipas pikës 6.3 të Udhëzimit nr. 2, urdhri duhet të përmbajë:

- identifikimin e debitorit;
- shumën e saktë që transferohet;
- të dhënat e llogarisë përfituese;
- radhën e preferimit kur ekzistojnë privilegje ligjore.

Respektimi i radhës së preferimit

Kur fondet nuk mjaftojnë për shlyerjen e të gjitha detyrimeve, përmbaruesi gjyqësor duhet të zbatojë radhën e preferimit të përcaktuar nga neni 605 i Kodit Civil.

5. Sanksionet ndaj bankave

Neni 598 i Kodit të Procedurës Civile parashikon vendosjen e sanksionit kur banka:

- nuk ekzekuton urdhrin e sekuestros;
- nuk ekzekuton urdhrin tërësisht;
- shkel afatet ligjore;
- nuk respekton radhën e preferimit.

Në këto raste, përmbaruesi gjyqësor:

- ka të drejtë të verifikojë dokumentacionin bankar;
- kryen verifikimin në prani të përfaqësuesit të bankës;
- mban procesverbal përkatës;
- cakton veprimet korrigjuese dhe afatet për zbatim.

Kur konstatohen shkelje, përmbaruesi mund të zbatojë masat e nenit 588 të KPC-së ndaj:

- punonjësit bankar përgjegjës;
- organit drejtues të bankës që ka urdhëruar veprime të parregullta.

Sipas nenit 599 të KPC-së, kundër vendimit të gjobës mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

Marrëdhënia ndërmjet KPC-së dhe Udhëzimit nr. 2 të Bankës së Shqipërisë. Procedura e sekuestros mbi llogaritë bankare rregullohet nga nenet 593-600 të Kodit të Procedurës Civile, ndërsa afatet, elementet e urdhrit të sekuestros, mënyra e komunikimit me bankat dhe procedura e transferimit të shumave rregullohen në mënyrë të detajuar nga Udhëzimi nr. 2, datë 27.03.2014 i Bankës së Shqipërisë, i nxjerrë në zbatim të nenit 600 të KPC-së. Përmbaruesi gjyqësor duhet të zbatojë në mënyrë të integruar të dy aktet normative.

Përdoret modeli nr. 23 "Udhër për vendosjen e sekuestros".

Përdoret modeli nr. 24 "Urdhrë për transferimin e shumës".

Përdoret modeli nr. 25 "vendim për gjobitjen e punonjësit banker përgjegjës".

Njoftimi i organit financiar sipas nenit 536 të KPC-së

Qëllimi

Neni 536 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se shteti konsiderohet gjithmonë kreditor pjesëmarrës në ekzekutim për detyrimet që debitori ka ndaj tij, kur këto rrjedhin nga tatimet ose kredi të tjera shtetërore dhe janë njoftuar përmbaruesit gjyqësor para ndarjes së shumave të realizuara nga ekzekutimi. Për këtë qëllim, përmbaruesi gjyqësor ka detyrimin të njoftojë seksionin përkatës të financës për çdo procedurë ekzekutimi të filluar, si dhe për çdo ndarje të shumave të realizuara.

Qëllimi i njoftimit

Ky njoftim synon:

- evidentimin e detyrimeve tatimore ose detyrimeve të tjera shtetërore të debitorit;
- garantimin e pjesëmarrjes së shtetit në procedurën e ekzekutimit;
- respektimin e radhës së preferimit gjatë shpërndarjes së shumave të realizuara;
- administrimin e saktë të projektit të ndarjes sipas neneve 536-538 të KPC-së.

Kur përdoret

Njoftimi dërgohet:

- pas regjistrimit të procedurës së ekzekutimit;
- përpara përgatitjes së projektit të ndarjes së shumave;
- sa herë që realizohen shuma nga ekzekutimi dhe do të procedohet me shpërndarjen e tyre.

Baza ligjore

Neni 536 i Kodit të Procedurës Civile:

"Shteti quhet gjithmonë si kreditor që merr pjesë bashkë me kreditorët e tjerë për detyrimin që po ai debitor i ka shtetit dhe të cilët rrjedhin nga tatimet dhe nga kredi të tjera, shuma e të cilëve i është njoftuar përmbaruesit gjyqësor, para se të bëhet ndarja e shumave të tjera. Për këtë qëllim, përmbaruesi gjyqësor njofton seksionin përkatës të financës për çdo ekzekutim të filluar prej tij dhe për çdo ndarje që ai bën."

Përdoret Modeli nr. 26 "Njoftim në zbatim të nenit 536 të Kodit të Procedurës Civile".

KAPITULLI V

PROJEKTI I NDARJES SË SHUMAVE NDËRMJET KREDITORËVE

Baza ligjore

Ndarja e shumave të realizuara nga ekzekutimi i detyrueshëm rregullohet nga nenet 534-539 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastet kur në procedurën e ekzekutimit marrin pjesë disa kreditorë dhe shuma e arkëtuar nuk mjafton për shlyerjen e plotë të të gjitha kredive, përmbaruesi gjyqësor detyrohet të përgatisë projektin e ndarjes së shumave sipas rregullave të preferimit dhe proporcionalitetit.

1. Pjesëmarrja e kreditorëve në ekzekutim

Sipas nenit 534 të KPC-së, deri në momentin e përgatitjes së projektit të ndarjes, në procedurën përmbarimore mund të marrin pjesë edhe kreditorë të tjerë të të njëjtit debitor. Kërkesës së tyre i bashkëngjitet urdhri i ekzekutimit ose dokumentacioni përkatës që provon ekzistencën e procedurës së ekzekutimit.

Sipas nenit 535 të KPC-së, kreditorët që bashkohen në procedurë gëzojnë të njëjtat të drejta me kreditorin që ka filluar ekzekutimin, përveç rasteve kur ekzistojnë shkaqe ligjore preferimi.

Kur debitori ka detyrime ndaj shtetit, zbatohet neni 536 i KPC-së, sipas të cilit shteti konsiderohet kreditor pjesëmarrës për detyrimet tatimore dhe detyrimet e tjera publike të njoftuara përpara ndarjes së shumave.

2. Hartimi i projektit të ndarjes

Kushtet për hartimin e projektit

Përmbaruesi gjyqësor përgatit projektin e ndarjes kur:

- janë realizuar të ardhura nga procedurat e ekzekutimit;
- ekzistojnë dy ose më shumë kreditorë;
- shuma e arkëtuar nuk është e mjaftueshme për shlyerjen e plotë të të gjithë kreditorëve.

Parimet që zbatohen

Sipas nenit 537 të KPC-së, përmbaruesi:

1. Veçon fillimisht kreditë që paguhen me preferim.
2. Zbrit shpenzimet procedurale që kanë prioritet ligjor.
3. Shpërndan pjesën e mbetur ndërmjet kreditorëve të tjerë në përpjesëtim me madhësinë e kredive të tyre.

3. Njoftimi i projektit të ndarjes

Pas hartimit të projektit, përmbaruesi gjyqësor njofton:

- debitorin;
- të gjithë kreditorët pjesëmarrës në procedurë.

Në njoftim caktohet dita kur palët njihen me projektin e ndarjes. Ky detyrim parashikohet nga neni 538 i KPC-së.

5. Miratimi përfundimtar i ndarjes

Kur brenda afatit ligjor nuk paraqitet ankim, projekti i ndarjes konsiderohet përfundimtar dhe përmbaruesi procedon me shpërndarjen e shumave sipas projektit të miratuar.

Në këtë rast, përmbaruesi:

1. Përgatit vendimin për miratimin e projektit të ndarjes.
2. Kryen pagesat përkatëse për secilin kreditor.
3. Administron mandatpagesat dhe dokumentacionin financiar në dosjen përmbarimore.

Përdoren modelet:

- **Nr. 27 "Projekti i ndarjes së shumave ndërmjet kreditorëve";**
- **Nr. 28 "Njoftimi i projektit të ndarjes";**
- **Nr. 29 "Vendim për miratimin e projektit të ndarjes së shumave";**
- **NR. 30 "Urdhër pagesë";**
- **Nr. 31 "Procesverbal i shpërndarjes së shumave".**

Kapitulli VI

Sekuestro mbi Sendet e Luajtshme

Qëllimi

Sekuestroja mbi sendet e luajtshme përbën një nga format kryesore të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve në të holla. Ajo realizohet nëpërmjet inventarizimit të pasurive të luajtshme të debitorit dhe synon garantimin e realizimit të të drejtës së kreditorit nëpërmjet shitjes së mëvonshme të tyre sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Baza ligjore e kësaj procedure parashikohet në nenet 540-548 të Kodit të Procedurës Civile.

1. Inventarizimi i sendeve

Sipas nenit 540 të Kodit të Procedurës Civile, sekuestroja mbi sendet e luajtshme realizohet nëpërmjet inventarizimit të tyre nga përmbaruesi gjyqësor. Në momentin e inventarizimit, mbi sendet vendoset etiketa e shërbimit të përmbarimit, e cila identifikon pasurinë si objekt sekuestrimi.

Sipas nenit 541 të KPC-së, inventarizimi përfshin vetëm:

- sendet që ndodhen në banesën e debitorit;
- sendet që ndodhen në ambiente të përbashkëta të debitorit me persona të tjerë;

përveç rasteve kur provohet se sendi është pronë e një personi tjetër.

Sipas nenit 543 të KPC-së, inventarizimi kryhet:

- në prani të debitorit;
- në mungesë të tij, në prani të një familjari madhor;
- në mungesë edhe të familjarëve, në prani të një përfaqësuesi të njësisë së qeverisjes vendore;

dhe në çdo rast duhet të jenë të pranishëm dy dëshmitarë.

2. Procesverbali i inventarizimit

Procesverbali i inventarizimit është akti themelor procedural që dokumenton vendosjen e sekuestros mbi sendet e luajtshme.

Sipas nenit 542 të Kodit të Procedurës Civile, procesverbali duhet të përmbajë:

- urdhrin e ekzekutimit mbi të cilin bazohet sekuestrimi;
- të dhënat e përmbaruesit, debitorit, kreditorit dhe personave të pranishëm;

- vendin, datën dhe orën e inventarizimit;
- pretendimet e personave të tretë;
- përshkrimin e hollësishëm të sendeve;
- vlerësimin e tyre;
- personin të cilit i lihen në ruajtje;
- nënshkrimet e pjesëmarrësve.

3. Vlerësimi i sendeve

Sipas nenit 544 të KPC-së, sendet e inventarizuara vlerësohen nga përmbaruesi gjyqësor në bazë të:

- çmimeve të tregut;
- vlerësimeve të ekspertëve;
- shkallës së konsumimit ose vjetërsisë së sendit.

Qëllimi i vlerësimit është përcaktimi i vlerës reale ekonomike të sendit, e cila do të shërbejë si bazë për procedurat e shitjes.

Në rast kundërshtimi nga palët mbi vlerën e sendit, përmbaruesi mund të kërkojë asistencën e ekspertëve përkatës.

4. Lënia në ruajtje e sendeve

Neni 545 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se sendet e inventarizuara mund t'i lihen në ruajtje debitorit. Debitori mund të vazhdojë t'i përdorë ato, për sa kohë nuk pakësohet vlera e tyre.

Kur debitori refuzon të marrë sendet në ruajtje, përmbaruesi gjyqësor cakton një person tjetër si ruajtës dhe përcakton shpërblimin përkatës.

Ruajtësi është i detyruar:

- të administrojë sendin me kujdes;
- të japë llogari për të ardhurat dhe shpenzimet;
- të mos disponojë sendin pa autorizim.

5. Sendet në bashkëpronësi

Sipas nenit 546 të KPC-së, kur sendi i sekuestruar është në bashkëpronësi ndërmjet debitorit dhe personave të tjerë, përmbaruesi:

1. inventarizon të gjithë pasurinë e përbashkët;
2. i drejtohet gjykatës kompetente;
3. kërkon caktimin e pjesës takuese të debitorit;
4. ekzekutimi kryhet vetëm mbi pjesën që gjykata përcakton si pronë të debitorit.

6. Sekuestrimi i sendeve të çmueshme

Neni 548 i Kodit të Procedurës Civile rregullon procedurën e veçantë për:

- arin;
- argjendin;
- platinin;
- gurët e çmuar;
- margaritarët;
- valutën e huaj;
- kambialet;
- çeqet;
- aksionet;
- obligacionet dhe titujt e tjerë me vlerë.

Këto sende nuk lihen në ruajtje pranë debitorit.

Ato depozitohen për ruajtje pranë një banke, e cila garanton sigurinë deri në përfundimin e procedurës së ekzekutimit.

7. Pavlefshmëria e disponimit pas vendosjes së sekuestros

Sipas nenit 547 të Kodit të Procedurës Civile, çdo disponim i sendit të luajtshëm nga debitori pas vendosjes së sekuestros është i pavlefshëm kundrejt kreditorëve që kanë kërkuar ekzekutimin.

Kjo do të thotë se:

- shitja;
- dhurimi;
- tjetërsimi;
- çdo formë kalimi e pronësisë,

nuk prodhon pasoja juridike ndaj kreditorit që ka vendosur sekuestron.

Përjashtim bën vetëm rasti kur sendi është fituar nga një person i tretë në mirëbesim, sipas nenit 166 të Kodit Civil.

Përdoret modeli nr. 32 "Urdhër për vendosjen e sekuestros dhe inventarizimin e sendeve të luajtshme".

Përdoret modeli nr. 33 "Vendim për përcaktimin e vlerës së sendit"

Kapitulli VII

Sekuestro mbi Pasuritë e Paluajtshme

Nënkapitulli I

Vendosja e Sekuestros

Qëllimi

Sekuestroja mbi pasuritë e paluajtshme është një nga format kryesore të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve në të holla. Ajo ka për qëllim sigurimin e pasurisë së paluajtshme të debitorit, pengimin e disponimit të saj dhe garantimin e realizimit të të drejtës së kreditorit nëpërmjet procedurës së shitjes së mëvonshme sipas ligjit.

Baza ligjore e kësaj procedure rregullohet në nenet **560-566 të Kodit të Procedurës Civile**.

1. Verifikimi i pronësisë së debitorit

Përpara vendosjes së sekuestros, përmbaruesi gjyqësor duhet të sigurohet se pasuria e paluajtshme është në pronësi të debitorit.

Sipas nenit **563** të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesit duhet t'i paraqiten dokumentet e pronësisë ose ai mund të kërkojë vetë informacion nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, nga organet financiare dhe të pushtetit vendor.

2. Urdhri i vendosjes së sekuestros

Pas verifikimit të pronësisë dhe fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm sipas nenit **519** dhe nenit **527** të KPC-së, përmbaruesi gjyqësor urdhëron vendosjen e sekuestros mbi pasurinë e paluajtshme të debitorit.

Përdoret modeli nr. 34 “Urdhër për vendosjen e sekuestros, drejtuar ASHK-së”.

Nënkapitulli II

Vlerësimi i Pasurisë

Qëllimi

Vlerësimi i pasurisë së paluajtshme përbën fazën procedurale që pason vendosjen dhe regjistrimin e sekuestros. Qëllimi i tij është përcaktimi i vlerës reale të tregut të pasurisë, e cila do të shërbejë si bazë për procedurën e shitjes në ankand dhe për caktimin e çmimit fillestar të ankandit sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Baza ligjore e kësaj procedure parashikohet në nenin **564** të Kodit të Procedurës Civile.

1. Marrëveshja e palëve mbi vlerën

Sipas paragrafit të parë të nenit 564 të KPC-së, kreditori dhe debitori kanë të drejtë të arrijnë një marrëveshje për vlerën e pasurisë së sekuestruar brenda **një jave** nga momenti i fillimit të procedurës së vlerësimit.

Përmbaruesi gjyqësor:

- njofton kreditorin dhe debitorin për të paraqitur qëndrimin e tyre mbi vlerën e pasurisë;
- administron çdo deklarim apo marrëveshje të përbashkët në dosjen përmbarimore;
- verifikon nëse vlera e propozuar është e qartë dhe e përcaktuar.

Nëse brenda afatit njëjavor palët bien dakord, vlera e dakordësuar pasqyrohet në aktin përkatës të procedurës. Në mungesë të marrëveshjes, procedohet me caktimin e ekspertit.

Përdoret modeli nr. 35: "Kërkesë për arritjen e marrëveshjes mbi vlerën e pasurisë së paluajtshme".

2. Caktimi i ekspertit

Kur kreditori dhe debitori nuk arrijnë marrëveshje mbi vlerën e pasurisë, neni 564 parashikon që pasuria të vlerësohet me vendim të përmbaruesit gjyqësor, në asistencën teknike të një eksperti të licencuar të fushës.

Eksperti duhet të jetë i licencuar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe të disponojë kompetencat profesionale të nevojshme për kryerjen e ekspertimit.

Udhëzim praktik

Në vendimin për caktimin e ekspertit duhet të pasqyrohen:

- të dhënat e procedurës përmbarimore;
- lloji dhe identifikimi i pasurisë;
- emri i ekspertit ose subjektit vlerësues;
- numri i licencës profesionale;
- objekti i ekspertimit;
- afati për paraqitjen e raportit.

Përmbaruesi duhet të sigurojë që eksperti të ketë akses në dokumentacionin e pasurisë, kartelën e pronës dhe të gjitha të dhënat e nevojshme për realizimin e vlerësimit.

Përdoret modeli nr. 36: "Vendim për caktimin e ekspertit".

3. Raporti i ekspertit

Pas kryerjes së ekspertimit, eksperti paraqet raportin e vlerësimit pranë përmbaruesit gjyqësor.

Sipas nenit 564 të KPC-së, vlera e pasurisë përcaktohet në bazë të metodologjisë së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Përmbaruesi gjyqësor mbështetet në raportin teknik të ekspertit për nxjerrjen e vendimit përfundimtar të vlerës.

4. Vendimi për përcaktimin e vlerës

Pas administrimit të raportit të ekspertit, përmbaruesi gjyqësor nxjerr vendimin për përcaktimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar. Ky vendim përbën aktin procedural që përcakton zyrtarisht vlerën e pasurisë që do të përdoret në procedurën e ankandit.

Sipas nenit 564 të KPC-së:

- përmbaruesi gjyqësor duhet të nxjerrë vendimin për vlerësimin brenda **15 ditëve**;
- brenda **10 ditëve** nga caktimi i vlerës duhet të njoftojë kreditorin dhe debitorin;
- kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim sipas nenit **610** të Kodit të Procedurës Civile.

Përmbajtja e vendimit

Vendimi duhet të përmbajë:

- të dhënat identifikuese të pasurisë;
- referimin e sekuestros së regjistruar;
- të dhënat e ekspertit;
- përmbledhjen e raportit të ekspertit;
- vlerën përfundimtare të pasurisë;
- njoftimin mbi të drejtën e ankimit.

Pas njoftimit të vendimit:

- akti administrohet në dosjen përmbarimore;

- raporti i ekspertit i bashkëlidhet vendimit;
- vlera e përcaktuar përdoret si bazë për shpalljen e ankandit;
- në zbatim të nenit 568 të KPC-së, çmimi fillestar i ankandit të parë do të jetë **80% e vlerës së përcaktuar sipas nenit 564**.

Përdoret modeli nr. 37: "Vendim për përcaktimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme të sekuestruar".

Nënkapitulli III

Ruajtja e Pasurisë së Sekuestruar

Qëllimi

Ruajtja e pasurisë së sekuestruar synon të garantojë mbajtjen, administrimin dhe konservimin e pasurisë së paluajtshme gjatë periudhës ndërmjet vendosjes së sekuestros dhe përfundimit të procedurës së shitjes ose shlyerjes së detyrimit. Gjatë kësaj periudhe duhet të shmanget çdo veprim që mund të cenojë ekzistencën, gjendjen juridike ose vlerën ekonomike të pasurisë.

Baza ligjore e kësaj faze parashikohet në nenin **565** të Kodit të Procedurës Civile, ndërsa ndalimi i disponimit të pasurisë nga debitori parashikohet në nenin **566** të KPC-së.

1. Lënia në ruajtje e pasurisë

Sipas nenit **565** të Kodit të Procedurës Civile, pasuria e paluajtshme e sekuestruar i lihet në ruajtje debitorit deri në momentin e shitjes së saj. Debitori ka detyrimin të kujdeset për pasurinë si për sendin e tij dhe të mos ndërmarrë veprime që cenojnë integritetin ose vlerën e saj.

Ruajtja nga debitori përbën rregullin e përgjithshëm, pasi ligji nuk parashikon heqjen automatike të posedimit të pasurisë së paluajtshme për shkak të vendosjes së sekuestros.

Përmbaruesi duhet:

- të evidentojë në dosje personin që mban pasurinë në ruajtje;
- të verifikojë periodikisht gjendjen e pasurisë kur rrethanat e diktojnë;
- të administrojë çdo informacion ose ankesë lidhur me dëmtimin apo keqadministrimin e saj.

2. Caktimi i personit ruajtës

Kur përmbaruesi gjyqësor konstaton se debitori nuk kujdeset si duhet për pasurinë e lënë në ruajtje, neni **565** i Kodit të Procedurës Civile i jep të drejtën të emërojë një person tjetër si ruajtës të pasurisë.

Shpërblimi i ruajtësit

Sipas nenit **565** të KPC-së:

- përmbaruesi dhe ruajtësi bien dakord për shpërblimin;
- shpërblimi paguhet nga të ardhurat e realizuara pas shitjes së pasurisë;
- shpenzimi përbën shpenzim proceduror të ekzekutimit.

Udhëzim praktik

Vendimi për caktimin e ruajtësit duhet të përmbajë:

- të dhënat e dosjes përmbarimore;
- identifikimin e pasurisë;
- arsyet e zëvendësimit të debitorit si ruajtës;
- identitetin e personit të caktuar;
- detyrimet e ruajtësit;
- shpërblimin ose mënyrën e përcaktimit të tij.

Përdoret modeli nr. 38 – "Vendim për caktimin e personit ruajtës".

3. Të ardhurat dhe shpenzimet e pasurisë

Neni **565** i Kodit të Procedurës Civile parashikon se debitori ose personi tjetër, të cilit i është lënë në ruajtje pasuria e sekuestruar, ka detyrimin të japë llogari për:

- të ardhurat e realizuara nga pasuria;
- shpenzimet e kryera për administrimin dhe ruajtjen e saj.

Përgjegjësia e ruajtësit

Sipas nenit **565** të KPC-së, debitori ose personi i caktuar si ruajtës përgjigjet sipas nenit **320 të Kodit Penal** për veprimet që pengojnë ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Kapitulli VIII

Sekuestro mbi Automjetet

Qëllimi

Sekuestroja mbi automjetet përbën një formë të ekzekutimit të detyrueshëm mbi pasuritë e luajtshme të debitorit dhe ka për qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimit në të holla nëpërmjet bllokimit dhe më pas realizimit të automjetit sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Automjeti konsiderohet send i luajtshëm dhe mbi të zbatohen dispozitat e sekuestrimit të sendeve të luajtshme, si dhe rregullat e posaçme të regjistrimit në regjistrat e mjeteve rrugore.

Baza ligjore:

- Neni 527 i Kodit të Procedurës Civile, për vendosjen e sekuestros mbi pasuritë e debitorit.
- Nenet 540-547 të Kodit të Procedurës Civile për sekuestrimin e sendeve të luajtshme.
- Neni 531 i Kodit të Procedurës Civile për ndalimin e disponimit pas vendosjes së sekuestros.

1. Verifikimi në DPSHTRR dhe Vendosja e Sekuestros

Përpara vendosjes së sekuestros, përmbaruesi gjyqësor duhet të verifikojë nëse automjeti rezulton në pronësi të debitorit dhe të sigurojë të dhënat identifikuese të tij. Kjo buron nga detyrimi i përgjithshëm i përmbaruesit për të verifikuar pasurinë e debitorit përpara fillimit të veprimeve të ekzekutimit. Sipas nenit 527 të Kodit të Procedurës Civile, sekuestroja vendoset mbi pasuritë e debitorit në masën e nevojshme për përmbushjen e detyrimit.

Efektet juridike

Nga momenti i vendosjes së sekuestros:

- debitori humbet të drejtën e disponimit të automjetit;
- ndalohet shitja, dhurimi ose transferimi i tij;
- automjeti i nënshtrohet procedurës së ekzekutimit.

Baza ligjore

Neni 531 i KPC-së parashikon se debitori nuk ka të drejtë të disponojë, ndryshojë, dëmtojë ose zhdukë sendin e sekuestruar.

Përdoret Modeli nr. 39: "Urdhër për informacion dhe vendosjen e sekuestros mbi automjet".

4. Kërkesa për bllokim fizik të automjetit nëpërmjet bashkëpunimit të Policisë Rrugore

Kur vendoset sekuestro mbi automjetin dhe ekziston nevoja për evidentimin, ndalimin ose bllokimin fizik të tij, përmbaruesi gjyqësor i kërkon mbështetje Policisë së Shtetit, në përputhje me nenin 523 të Kodit të Procedurës Civile, i cili detyron organet shtetërore të japin ndihmën e kërkuar për realizimin e veprimeve të ekzekutimit.

Përdoret Modeli nr. 40 "Kërkesë për bashkëpunim për bllokim fizik të Policisë Rrugore për bllokimin fizik të automjetit".

5. Inventarizimi dhe Marrja në Ruajtje e Automjetit

Meqenëse automjeti është send i luajtshëm, zbatohen nenet 540-545 të KPC-së. Sekuestroja materializohet në procesverbal me inventarizimin e mjetit dhe përshkrimin e tij të plotë.

6. Lënia në Ruajtje ose Sekuestrimi Fizik

Sipas nenit 545 të KPC-së, sendi i sekuestruar mund t'i lihet në ruajtje debitorit ose një personi tjetër të caktuar nga përmbaruesi.

Praktikisht ekzistojnë dy situata:

a) Automjeti lihet në ruajtje te debitori

Kur nuk ekziston rrezik fshehjeje ose dëmtimi.

Debitori paralajmërohet se:

- nuk mund ta shesë;
- nuk mund ta transferojë;
- nuk mund ta fshehë;
- nuk mund ta dëmtojë.

Në të kundërt përgjigjet sipas nenit 531 të KPC-së dhe nenit 320 të Kodit Penal.

b) Automjeti merret fizikisht

- Kur ekziston rrezik që:
- të fshihet;
- të tjetërsohet;
- të nxirret jashtë vendit;
- të dëmtohet;

- të pengohet ekzekutimi.

Në këtë rast automjeti dorëzohet në një parkim të autorizuar ose te ruajtësi i caktuar nga përmbaruesi me Vendim për marrjen në ruajtje të automjetit.

6. Kalimi në Procedurën e Shitjes

- Pas inventarizimit dhe vlerësimit të automjetit:
- zbatohet neni 549 i KPC-së;
- debitori njoftohet se automjeti do të shitet nëse brenda 5 ditëve nuk shlyen detyrimin;
- vijon procedura e ankandit sipas neneve 549-559 të KPC-së.

Kapitulli IX

Sekuestro mbi Kuotat dhe Aksionet në Shoqëritë Tregtare

1. Verifikimi në QKB

Qëllimi

Përpara vendosjes së sekuestros, përmbaruesi duhet të verifikojë nëse debitori zotëron kuota ose aksione në një ose më shumë shoqëri tregtare dhe të identifikojë me saktësi pjesëmarrjen e tij në kapitalin e shoqërisë.

Ky veprim mbështetet në detyrimin e përmbaruesit për t'u siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe të drejtave pasurore të debitorit përpara vendosjes së sekuestros, sipas neneve 581 dhe 582 të KPC-së.

Veprimet procedurale

Përmbaruesi:

1. Verifikon të dhënat e debitorit në regjistrin tregtar të administruar nga QKB.
2. Identifikon:
    - shoqërinë ose shoqëritë ku debitori është ortak ose aksioner;
    - numrin e kuotave ose aksioneve;
    - përqindjen e pjesëmarrjes në kapital;
    - të dhënat identifikuese të shoqërisë.
3. Administron ekstraktin historik dhe/ose ekstraktin e thjeshtë të regjistrit tregtar si provë në dosjen e ekzekutimit.

Në mbështetje të nenit 41 të Ligjit nr. 8/2023, përmbaruesi ka të drejtë të kërkojë informacion nga institucionet publike dhe subjektet që disponojnë të dhëna mbi pasurinë e debitorit.

2. Vendosja e sekuestros

Baza ligjore

Sipas nenit 527 të KPC-së, kur ekzekutohet një detyrim në të holla, përmbaruesi vendos sekuestër mbi kreditë dhe pasuritë e debitorit në masën e nevojshme për realizimin e detyrimit. Kuotat dhe aksionet përbëjnë të drejta pasurore të sekuestrueshme.

Në momentin e vendosjes së sekuestros zbatohen edhe efektet e nenit 531 të KPC-së, sipas të cilit debitori nuk mund të disponojë më pasurinë e sekuestruar.

Përdoret modeli nr. 41 “Urdhër për vendosjen e sekuestros, drejtuar QKB”.

Kapitulli X

Sekuestro mbi Mjetet e Lundrimit dhe të Fluturimit

1. Sekuestro mbi anijet

Qëllimi

Sekuestroja mbi anijen vendoset për të garantuar realizimin e detyrimit të debitorit kur kjo pasuri përbën objekt ekzekutimi.

Pas mbarimit të afatit për ekzekutim vullnetar sipas nenit 517 të KPC-së, ose në rastet e nenit 519 të KPC-së kur ekziston rrezik për pamundësimin e ekzekutimit, përmbaruesi fillon ekzekutimin e detyrueshëm duke vendosur sekuestër mbi pasurinë e debitorit.

Baza ligjore

Procedura e sekuestrimit të mjeteve të lundrimit dhe të fluturimit mbështetet në dispozitat e përgjithshme të ekzekutimit të detyrueshëm dhe në rregullat e posaçme të parashikuara në nenet 561 dhe 562 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu zbatohen nenet 517-519, 523, 524, 527, 531 dhe 610 të KPC-së.

Përmbaruesi gjyqësor ushtron kompetencat e tij në përputhje me Kodin e Procedurës Civile dhe Ligjin nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror".

Veprimet procedurale

Përmbaruesi:

1. Verifikon pronësinë e anijes dhe të dhënat e regjistrimit të saj.
2. Harton procesverbalin e sekuestrimit.
3. Përshkruan në procesverbal elementet e detyrueshme të parashikuara nga neni 561 i KPC-së:
    - emrin e pronarit;
    - kombësinë e pronarit;
    - emrin e anijes;
    - përshkrimin e anijes;
    - kapacitetin e saj;
    - të dhëna të tjera që lidhen me regjistrimin detar.
4. Mban procesverbal për veprimin e kryer, sipas nenit 524 të KPC-së.

Përdoret model nr. 42 “Urdhër për vendosjen e sekuestros mbi mjetet e lundrimit”.

2. Sekuestro mbi mjetet e fluturimit

Qëllimi

Sekuestroja mbi mjetin e fluturimit vendoset për garantimin e realizimit të titullit ekzekutiv ndaj pasurisë së debitorit.

Veprimet procedurale

Në përputhje me nenin 562 të KPC-së, përmbaruesi:

1. Identifikon mjetin e fluturimit dhe verifikon pronësinë e tij.
2. Harton procesverbalin e sekuestrimit.
3. Përfshin në procesverbal:
    - emrin e pronarit;
    - kombësinë e pronarit;
    - shenjat dalluese të mjetit;
    - vendin e regjistrimit;
    - kapacitetin;
    - të dhëna të tjera identifikuese të nevojshme.
4. Administron të gjithë dokumentacionin në dosjen përmbarimore.
5. Mban procesverbal sipas kërkesave të nenit 524 të KPC-së.

Përdoret model nr. 43 "Urdhër për vendosjen e sekuestros mbi mjetin e fluturimit.

KAPITULLI XI

EKZEKUTIMI I DETYRIMIT PËR KRYERJEN OSE MOSKRYERJEN E NJË VEPRIMI TË CAKTUAR

Qëllimi

Ky kapitull rregullon procedurën përmbarimore që ndiqet kur titulli ekzekutiv përmban detyrimin e debitorit për të kryer ose për të mos kryer një veprim të caktuar.

Kjo kategori përfshin detyrime jo monetare, të cilat nuk kanë si objekt pagesën e një shume parash apo dorëzimin e një sendi, por realizimin ose ndalimin e një sjelljeje të caktuar të debitorit, të urdhëruar nga gjykata ose që rrjedh nga një titull tjetër ekzekutiv.

Baza ligjore

- Neni 605 i Kodit të Procedurës Civile.
- Neni 606 i Kodit të Procedurës Civile.
- Neni 523 i Kodit të Procedurës Civile.
- Neni 524 i Kodit të Procedurës Civile.

1. Kuptimi i detyrimit për kryerjen e një veprimi

Detyrimi për kryerjen e një veprimi ekziston kur debitori është urdhëruar të realizojë një veprim konkret në favor të kreditorit.

2. Veprimi që mund të kryhet nga persona të tjerë

Sipas nenit 605 të Kodit të Procedurës Civile, kur detyrimi lidhet me një veprim që mund të kryhet edhe nga persona të tjerë përveç debitorit, kreditori mund të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor autorizimin për ta realizuar vetë këtë veprim në kurriz të debitorit.

Kushtet

Përmbaruesi lejon kryerjen e veprimit kur:

- ekziston titull ekzekutiv i formës së prerë;
- debitori është njoftuar për ekzekutim vullnetar;
- ka kaluar afati i përcaktuar për përmbushjen vullnetare;
- debitori nuk ka ekzekutuar detyrimin;
- veprimi nuk ka karakter strikt personal.

3. Vendimi për autorizimin e kreditorit

Pas verifikimit të kushteve ligjore, përmbaruesi gjyqësor nxjerr vendim me të cilin autorizon kreditorin të kryejë vetë veprimin ose ta realizojë nëpërmjet personave të tretë.

Vendimi duhet të përmbajë:

- të dhënat e titullit ekzekutiv;
- përshkrimin e detyrimit;
- konstatimin e moszbatimit nga debitori;
- autorizimin për kryerjen e veprimit;
- mënyrën e dokumentimit të realizimit të tij;
- të drejtën e ankimit sipas nenit 610 të KPC-së.

4. Shpenzimet e kryerjes së veprimit

Shpenzimet e realizuara nga kreditori për kryerjen e veprimit i ngarkohen debitorit.

Për këtë qëllim kreditori duhet të paraqesë:

- kontratat me subjektet që kanë kryer punimet;
- faturat tatimore;
- mandatet e pagesës;
- çdo dokument tjetër justifikues.

Këto shuma bëhen pjesë e detyrimit për ekzekutim dhe mund të mblidhen sipas rregullave të ekzekutimit të detyrimeve monetare.

5. Detyrimet për moskryerjen e një veprimi

Kur titulli ekzekutiv urdhëron debitorin të mos kryejë një veprim të caktuar dhe debitori vepron në kundërshtim me të, përmbaruesi gjyqësor dokumenton shkeljen dhe urdhëron rivendosjen e situatës sipas përmbajtjes së titullit ekzekutiv.

Nëse rivendosja kërkon ndërhyrjen e personave të tretë, procedohet sipas nenit 605 të Kodit të Procedurës Civile.

6. Sanksionet ndaj debitorit

Sipas nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, kur debitori:

- refuzon të kryejë veprimin;
- kryen veprimin në mënyrë të parregullt;
- nuk respekton afatet;
- kryen të kundërtën e asaj që urdhëron vendimi;

dhe nuk ka vend për përgjegjësi penale, përmbaruesi gjyqësor mund ta gjobisë deri në 50 000 lekë për çdo rast deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit.

Personat e tjerë të detyruar

E njëjta masë mund të zbatohet edhe ndaj personave të tjerë të cilët sipas ligjit ose titullit ekzekutiv janë të detyruar të bashkëpunojnë për realizimin e detyrimit.

7. Dokumentimi i procedurës

Për çdo veprim të kryer përmbaruesi gjyqësor harton procesverbal sipas nenit 524 të Kodit të Procedurës Civile.

8. Kërkesa për bashkëpunim institucional

- Kur realizimi i veprimit kërkon asistencë të institucioneve publike, përmbaruesi gjyqësor kërkon bashkëpunimin e:
- Policisë së Shtetit;
- njësive të vetëqeverisjes vendore;
- Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit;
- institucioneve të tjera kompetente sipas natyrës së veprimit.

PJESA VII

ANKANDET

Qëllimi

Ankandi është procedura përmes së cilës realizohet shitja e pasurisë së sekuestruar me qëllim përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në titullin ekzekutiv. Procedura e ankandit zhvillohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe me rregullat e hollësishme të përcaktuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 12.12.2012 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbaruesi gjyqësor".

Gjatë zhvillimit të procedurës së ankandit, përmbaruesi gjyqësor respekton parimet e ligjshmërisë, transparencës, barazisë së pjesëmarrësve dhe garantimit të procesit të rregullt ligjor.

Kapitulli I

Pasuritë e Paluajtshme

Baza ligjore: Nenet 567-580 të Kodit të Procedurës Civile dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 12.12.2012 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbaruesi gjyqësor".

1. Vendim për zhvillimin e ankandit

Pas vendosjes së sekuestros dhe vlerësimit të pasurisë, përmbaruesi gjyqësor i dërgon debitorit lajmërim se pasuria e sekuestruar do të shitet në ankand nëse brenda 10 ditëve nuk përmbush detyrimin. Me kalimin e këtij afati nxirret vendimi për zhvillimin e procedurës së ankandit dhe bëhet shpallja për shitje.

- Vendimi duhet të përmbajë:
- referimin e dosjes përmbarimore;
- identifikimin e pasurisë;
- vlerën e përcaktuar sipas nenit 564;
- bazën ligjore të shitjes në ankand;
- urdhërimin e fillimit të procedurës së ankandit.

Përdoret Modeli nr. 44: "Vendim për zhvillimin e ankandit".

2. Ankandi I

Ankandi i parë zhvillohet sipas neneve 568-575 të KPC-së.

Shpallja për shitjen në ankand afishohet:

- në zyrën përmbarimore vendore;
- në vendin ku ndodhet pasuria;
- në gjykatë;
- në bashki ose njësi administrative;
- në vende të tjera publike;
- për 5 ditë rresht në dy gazeta kombëtare me tirazhin më të madh.

Shitja nuk mund të zhvillohet para kalimit të 15 ditëve nga shpallja e ankandit.

Çmimi fillestar është 80% e vlerës së përcaktuar sipas nenit 564 të KPC-së.

Çdo ofertues duhet të depozitojë garanci në masën 10% të çmimit fillestar.

Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal dhe fitues shpallet ofertuesi që ka paraqitur ofertën me çmimin më të lartë.

Përdoret Modeli nr. 45: "Shpallje Ankandi I".

3. Ankandi II

Kur në ankandin e parë nuk paraqitet asnjë ofertues, përmbaruesi gjyqësor brenda 10 ditëve cakton çmimin e ri të pasurisë. Çmimi i ri nuk mund të jetë më i ulët se 30% e çmimit fillestar të ankandit të parë. Ankandi i dytë zhvillohet 30 ditë pas caktimit të çmimit të ri.

Procedurat e shpalljes, publikimit dhe zhvillimit të ankandit janë të njëjta me ato të ankandit të parë.

Përdoret Modeli nr. 46: "Shpallje Ankandi II".

4. Ankandi III

Nëse edhe ankandi i dytë rezulton pa ofertues, përmbaruesi gjyqësor cakton çmim të ri, i cili nuk mund të jetë më i ulët se 10% e çmimit të ankandit të dytë. Ankandi i tretë zhvillohet jo më vonë se 30 ditë nga caktimi i çmimit të ri.

Edhe në këtë fazë zbatohen të njëjtat rregulla të shpalljes dhe zhvillimit të ankandit.

Përdoret Modeli nr. 47: "Shpallje Ankandi III".

5. Deklarata e mungesës së konfliktit të interesit

Sipas rregullave të përcaktuara për zhvillimin e ankandit, çdo ofertues duhet të deklarojë se nuk ndodhet në konflikt interesi me përmbaruesin gjyqësor. Përmbaruesi gjyqësor refuzon pjesëmarrjen në procedurën e ankandit të çdo personi që rezulton në konflikt interesi ose që ndodhet në kushtet e ndalimit ligjor për të marrë pjesë në ankand.

Përdoret Modeli nr. 48: "Deklaratë për mungesën e konfliktit të interesit".

6. Kalimi i pronësisë

Fituesi i ankandit duhet të paguajë çmimin e blerjes brenda 15 ditëve nga mbarimi i ankandit. Pas pagesës së çmimit dhe taksave përkatëse, përmbaruesi gjyqësor nxjerr vendimin për kalimin e pasurisë në pronësi të blerësit.

Nga data e nxjerrjes së këtij vendimi, blerësi fiton të gjitha të drejtat që debitori kishte mbi pasurinë.

Përdoret Modeli nr. 49: "Vendim për kalimin e pronësisë".

7. Marrja në pronësi nga kreditori

Kur edhe ankandi i tretë nuk ka ofertues, përmbaruesi gjyqësor i propozon kreditorit marrjen e pasurisë kundrejt kredisë së tij me çmimin e ankandit të tretë.

Nëse kreditori nuk pranon brenda 30 ditëve nga marrja e propozimit:

- hiqet sekuestroja mbi pasurinë;
- procedohet mbi pasuri të tjera të debitorit.

Kur kreditorët janë disa, pronësia i kalon kreditorit që ofron çmimin më të lartë.

Përdoret Modeli nr. 50: "Propozim për marrjen e pasurisë së paluajtshme në pronësi nga kreditori".

Kapitulli II

Sendet e Luajtshme

Baza ligjore: Nenet 549-559 të Kodit të Procedurës Civile.

1. Ankandi I

Pas sekuestrimit të sendit dhe kalimit të afatit 5-ditor të lajmërimit për shitje, përmbaruesi organizon shitjen me ankand.

Çmimi fillestar i ankandit të parë është 80% e çmimit të përcaktuar sipas nenit 552 të KPC-së.

Shpallja duhet të përmbajë:

- përshkrimin e sendit;
- çmimin fillestar;
- vendin, datën dhe orën e ankandit.

Për të gjitha veprimet mbahet procesverbal dhe fitues shpallet ofertuesi që jep çmimin më të lartë.

Përdoret Modeli nr. 51: "Shpallje Ankandi I për sendet e luajtshme".

2. Ankandi II

Kur në ankandin e parë nuk paraqitet asnjë ofertues, përmbaruesi gjyqësor, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, cakton çmim të ri jo më të ulët se 30% e çmimit fillestar të ankandit të parë dhe organizon ankandin e dytë.

Nëse edhe ankandi i dytë rezulton pa ofertues, kreditorit i propozohet marrja e sendit kundrejt kredisë së tij. Në rast mospranimi, hiqet sekuestroja dhe procedohet mbi pasuri të tjera të debitorit.

Përdoret Modeli nr. 52: "Shpallje Ankandi II për sendet e luajtshme".

Akte të tjera:

Përdoret Modeli nr. 53: "Vendim për kalimin në pronësi të sendit të blerë në ankand".

PJESA VIII

PEZULLIMI, PUSHIMI I PROCEDURËS

Qëllimi

Pezullimi, pushimi i urdhrit të ekzekutimit përbëjnë fazën përmbyllëse të procedurës përmbarimore. Këto veprime përmbarimore synojnë garantimin e ligjshmërisë së ekzekutimit dhe shmangien e vazhdimit të procedurës në rastet kur ligji parashikon pezullimin ose pushimin e saj.

Baza ligjore

Baza ligjore rregullohet kryesisht nga nenet 516, 516/a, 609, 610, 615, 616 dhe 617 të Kodit të Procedurës Civile.

Kapitulli I

Pezullimi i Procedurës së Ekzekutimit

1. Vendim për pezullim

Pezullimi i ekzekutimit nënkupton ndërprerjen e përkohshme të procedurës përmbarimore pa sjellë përfundimin e saj.

Sipas nenit 615 të Kodit të Procedurës Civile, ekzekutimi pezullohet:

- me vendim të gjykatës në rastet e parashikuara nga ligji;
- me kërkesë të kreditorit;
- në rastet e parashikuara nga neni 297 i KPC-së;
- në raste të tjera të parashikuara nga ligji;
- kur përmbaruesi nuk gjen pasuri të debitorit brenda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit;
- kur kreditori nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë i përmbaruesit.

Pezullimi mund të vendoset edhe nga gjykata në rastet e parashikuara nga nenet 609, 610 dhe 612 të Kodit të Procedurës Civile.

Përdoret Modeli nr. 54 "Vendim për Pezullimin e Procedurës së Ekzekutimit".

2. Vendim për transferim për kompetencë tokësore

Sipas nenit 516 të Kodit të Procedurës Civile, kur përmbaruesi gjyqësor konstaton se nuk është kompetent territorial për të vazhduar procedurën e ekzekutimit, ai ia transferon çështjen përmbaruesit kompetent.

Para transferimit, përmbaruesi mund të vendosë masat e nevojshme për sigurimin e ekzekutimit, përfshirë vendosjen e sekuestros mbi pasurinë ose kreditë e debitorit.

Përdoret Modeli nr. 55 "Vendim për Transferimin për Kompetencë Tokësore".

Kapitulli II

Pushimi i Procedurës së Ekzekutimit

1. Vendim për pushim

Pushimi i ekzekutimit sjell përfundimin e procedurës përmbarimore.

Sipas nenit 616 të Kodit të Procedurës Civile, ekzekutimi pushon:

a. Kur detyrimi është ekzekutuar

Kur debitori provon se ka shlyer detyrimin sipas titullit ekzekutiv.

b. Kur kreditori heq dorë nga ekzekutimi

Kur kreditori paraqet deklaratë me shkrim për heqje dorë nga procedura përmbarimore.

c. Kur titulli ekzekutiv shpallet i pavlefshëm

Në rastet kur gjykata, me vendim të formës së prerë sipas nenit 609 të KPC-së, deklaron se:

- titulli ekzekutiv është i pavlefshëm;
- detyrimi nuk ekziston;
- detyrimi ekziston në masë më të vogël;
- detyrimi është shuar.

ç. Kur pranohen ankimet kundër procedurës përmbarimore

Kur gjykata pranon ankimin sipas nenit 610 të KPC-së ose padinë e personit të tretë sipas nenit 612 e vijues të KPC-së.

Me pushimin procedohet me heqjen e urdhrave të sekuestros, pasi vendimi ka marrë formë të prerë.

Përdoret Modeli nr. 56 "Vendim për Pushimin e Urdhrit të Ekzekutimit".

Kapitulli III

Heqja e Sekuestros

1. Urdhër për heqje sekuestroje

Heqja e sekuestros është pasojë e drejtpërdrejtë e mbarimit ose pushimit të procedurës së ekzekutimit.

Sipas nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile, kur vendimi i pushimit merr formë të prerë, përmbaruesi gjyqësor heq sekuestron e vendosur mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme.

Veprimet që kryhen

Përmbaruesi:

- nxjerr urdhrin për heqjen e sekuestros;
- njofton institucionet përkatëse;
- kërkon çregjistrimin e sekuestros në ASHK, DPSHTRR apo institucione të tjera sipas rastit;
- njofton palët.

Urdhër për heqje sekuestroje pas pushimit

Kur procedura është pushuar sipas nenit 616 dhe vendimi për pushim ka marrë formë të prerë, përmbaruesi nxjerr akt të posaçëm për heqjen e sekuestros së vendosur gjatë procedurës.

Përdoret Modeli nr. 56/1 "Urdhër për Heqjen e Sekuestros pasi vendimi pushimit ka marrë formë të prerë".

PJESA IX

EKZEKUTIMI NDAJ INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE SEKUESTROJA NË DEGËN E THESARIT

Qëllimi

Kjo pjesë rregullon procedurën e ekzekutimit të detyrimeve monetare ndaj njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe vendosjen e masës së sekuestros në Degën e Thesarit, në rastet kur institucioni debitor nuk përmbush vullnetarisht detyrimin që rrjedh nga titulli ekzekutiv.

Kapitulli I

Ekzekutimi ndaj Institucioneve Buxhetore

1. Baza ligjore

Sipas nenit 589 të Kodit të Procedurës Civile:

- ekzekutimi i detyrimeve monetare ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogaritë e tyre bankare;
- në kreditë që ato kanë ndaj të tretëve;
- dhe, kur nuk ekzistojnë të tilla, në llogaritë e thesarit;
- nuk lejohet ekzekutimi mbi pasurinë e luajtshme apo të paluajtshme të institucionit buxhetor.

2. Njoftimi për ekzekutim vullnetar

Përmbaruesi gjyqësor fillimisht ndjek procedurën e përgjithshme të neneve 517-519 të Kodit të Procedurës Civile duke i dërguar institucionit debitor:

- lajmërimin për ekzekutim vullnetar;
- titullin ekzekutiv;
- urdhrin e ekzekutimit.

Institucioni debitor ka detyrimin të përmbushë detyrimin brenda afatit ligjor.

3. Procedura e pagesës vullnetare

Njësia shpenzuese është përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre. Pagesa kryhet sipas radhës së paraqitjes së vendimeve dhe fondeve të parashikuara në buxhet.

Në rastet kur institucioni disponon fondet e nevojshme, pagesa kryhet pa pasur nevojë për masa të detyruara.

Kapitulli II

Vendosja e Sekuestros në Degën e Thesarit

1. Kushtet për vendosjen e sekuestros

Sipas pikës 9 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 të Këshillitt ë Ministriave "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit", kur institucioni debitor nuk ndjek procedurat e pagesës vullnetare, përmbaruesi fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm në llogarinë e thesarit.

2.Urdhri për vendosjen e sekuestros në degë të thesarit

Përmbaruesi gjyqësor i dërgon:

- titullarit të institucionit debitor;
- Degës së Thesarit;

dokumentacionin përkatës, i cili përfshin:

- provën e njoftimit të institucionit për ekzekutim vullnetar;
- vendimin gjyqësor që përbën titull ekzekutiv;
- urdhrin për vendosjen e sekuestros.

Përdoret Modeli nr. 58 "Urdhër për vendosjen e sekuestros në Degën e Thesarit".

3. Veprimet e institucionit debitor

Titullari i njësisë shpenzuese, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës së përmbaruesit, duhet t'i kërkojë Degës së Thesarit kryerjen e pagesës së detyrimit.

Afati ligjor

- 5 ditë për veprimin e institucionit debitor.

4. Veprimet e Degës së Thesarit

Dega e Thesarit, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës së titullarit të institucionit debitor, kryen pagesën e shumës përkatëse.

Afati ligjor

- 10 ditë nga paraqitja e kërkesës.

5. Vendosja e masës së sekuestros

Kur titullari i institucionit nuk paraqet kërkesën për pagesë brenda afatit 5-ditor, Dega e Thesarit vendos masën e sekuestros mbi shpenzimet operative të institucionit.

Sekuestroja vendoset:

- deri në masën e detyrimit;
- pa cenuar shpenzimet e domosdoshme për funksionimin e institucionit.

6. Kufizimet ligjore të sekuestros

Sipas Udhëzimit:

nuk mund të preken:

- shpenzimet për energjinë elektrike;
- furnizimin me ujë;
- materiale dhe shërbime speciale të domosdoshme për funksionimin normal të institucionit.

Gjithashtu **nuk mund të vendoset sekuestro mbi të ardhurat në burim të Buxhetit të Shtetit**, pasi ato nuk konsiderohen fonde të njësisë debitore.

Kapitulli III

Përfundimi i Procedurës

1. Shlyerja e detyrimit

Pas kryerjes së pagesës nga Dega e Thesarit:

- përmbaruesi konstaton shlyerjen e plotë ose të pjesshme të detyrimit;
- administron dokumentacionin financiar;
- përgatit procesverbalin përmbyllës të procedurës.

2. Heqja e sekuestros

Pas shlyerjes së detyrimit, përmbaruesi nxjerr urdhrin për heqjen e sekuestros dhe e njofton Degën e Thesarit dhe institucionin debitor.

Përdoret Modeli nr. 59: "Urdhër për heqjen e sekuestros në Degën e Thesarit".

PJESA X

EKZEKUTIMI I GJOBAVE PENALE

Qëllimi

Ekzekutimi i dënimit me gjobë është pjesë e ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë dhe realizohet nëpërmjet shërbimit përmbarimor gjyqësor. Përmbaruesi gjyqësor ekzekuton gjobën penale mbi bazën e urdhrit të ekzekutimit të nxjerrë nga prokurori dhe sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile për ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Baza ligjore:

- Neni 16 i ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale", sipas të cilit shërbimi përmbarimor ekzekuton gjobat penale.
- Nenet 42 dhe 43 të ligjit nr. 79/2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale".
- Nenet 515-617 të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa janë të zbatueshme në procedurën e ekzekutimit.

Kapitulli I

Fillimi i Procedurës së Ekzekutimit

Sipas nenit 42 të ligjit nr. 79/2020, ekzekutimi i gjobës penale bëhet mbi bazën e urdhrit të ekzekutimit të prokurorit dhe realizohet nga organi përmbarimor në territorin ku ka vendbanimin i dënuari. Përmbaruesi gjyqësor regjistron procedurën në përputhje me nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile dhe vijon me njoftimin për ekzekutim vullnetar sipas neneve 517-519 të KPC-së.

Kapitulli II

Kërkesa për Qëndrim mbi Amnistinë

1. Verifikimi paraprak

Përpara vijimit të procedurës së ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor duhet të verifikojë nëse:

- ekziston një ligj amnistie i zbatueshëm;
- gjoba ose pjesa e pashlyer e saj është përfshirë në efektet e amnistisë;
- prokuroria disponon akt ose interpretim lidhur me përfitimin nga amnistia.

2. Kërkesa drejtuar Prokurorisë

Kur lind dyshimi për zbatimin e një ligji amnistie, përmbaruesi gjyqësor i drejtohet prokurorisë kompetente për të marrë qëndrim zyrtar mbi vijimin ose jo të ekzekutimit.

Përdoret Modeli nr. 60 "Kërkesë për qëndrim mbi përfitimin nga amnistia".

Kapitulli III

Kërkesa për Konvertimin e Gjobës në Burgim

1. Pamundësia e ekzekutimit

Sipas nenit 43 të ligjit nr. 79/2020, kur ekzekutimi i gjobës është i pamundur tërësisht ose pjesërisht, organi përmbarimor njofton prokurorin.

2. Njoftimi i Prokurorisë

Pas konstatimit të pamundësisë së ekzekutimit, përmbaruesi përgatit relacionin dhe njofton prokurorin kompetent për rezultatet e procedurës së ekzekutimit.

3. Kërkesa për konvertim

Në bazë të nenit 43 të ligjit nr. 79/2020, prokurori i paraqet kërkesë gjykatës së vendit të ekzekutimit për konvertimin e gjobës.

Përmbaruesi nuk kërkon drejtpërdrejt konvertimin e gjobës në burgim. Kompetenca për paraqitjen e kërkesës i përket prokurorit.

Përdoret Modeli nr. 61 " KËRKESË PËR MARRJEN E MASAVE PËRE KONVERTIMIN E GJOBËS PENALE NË DËNIM ME BURGIM, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË SË EKZEKUTIMIT"

PJESA X1

ANEKS - Modelet e formularëve

Çdo dosje përmbarimore duhet të administrohet me fletë inventarizimi, e cila vendoset në faqen e parë të dosjes dhe përditësohet gjatë gjithë procedurës përmbarimore deri në arkivimin e saj.

Modeli nr. -1

FLETË INVENTARIZIMI E DOSJES PËRMBARIMORE

Zyra Përmbarimore: _____

Nr. i Dosjes Përmbarimore: _____

Kreditor: _____

Debitor: _____

Objekti i Ekzekutimit: _____

Nr. rendor	Nr. prot./datë	Emërtimi i aktit ose dokumentit	Nr. i fletëve	Shënime
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
...				

Nr. rendor	Nr. prot./datë	Emërtimi i aktit ose dokumentit	Nr. i fletëve	Shënime

MODELI NR. 0

KËRKESË PËR VËNIEN NË EKZEKUTIM TË TITULLIT EKZEKUTIV / URDHRIT TË EKZEKUTIMIT

Drejtuar: ZYRËS PËRMBARIMORE VENDORE _____

KËRKUES (KREDITOR)

Emër/Mbiemër: _____

Atësia: _____

Nr. Personal / NIPT: _____

Adresa: _____

Tel/E-mail: _____

Përfaqësuar nga (nëse ka): _____

Në cilësinë e: □ Person Fizik □ Person Juridik

PALA DEBITORE

Emër/Mbiemër: _____

Atësia: _____

Nr. Personal / NIPT: _____

Adresa: _____

Tel/E-mail (nëse dihet): _____

OBJEKTI

Kërkoj vënien në ekzekutim të:

□ Urdhrit të Ekzekutimit nr. _____, datë _____

lëshuar për:

□ Vendimin gjyqësor nr. _____, datë _____

□ Aktin noterial nr. _____, datë _____

□ Kontratën e kredisë bankare / IFJB

□ Çekun / kambialin

□ Titull tjetër ekzekutiv _____

BAZA E KËRKESËS

Në mbështetje të nenit 515 të Kodit të Procedurës Civile, kërkoj fillimin e procedurës përmbarimore për realizimin e detyrimit të përcaktuar në titullin ekzekutiv të sipërcituar.

DETYRIMI QË KËRKOHET TË EKZEKUTOHET

Pala debitore është detyruar:

Shuma kryesore: _____ lekë/euro

Interesa: _____ lekë/euro

Shpenzime gjyqësore: _____ lekë/euro

Vlera totale që kërkohet të ekzekutohet: _____ lekë/euro

INFORMACION MBI PASURITË E DEBITORIT (NËSE DISPONOHEN)

Kreditori deklaron se ka dijeni se debitori zotëron:

□ Pasuri të paluajtshme

□ Automjete

□ Llogari bankare

□ Pagë ose të ardhura

□ Kuota/Aksione në shoqëri tregtare

□ Pasuri të tjera

Të dhëna shtesë:

KËRKOJ

1. Regjistrimin e kërkesës për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.
2. Fillimin e procedurës përmbarimore sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.
3. Marrjen e të gjitha masave ligjore për realizimin e detyrimit.

BASHKËLIDHUR

□ Titulli Ekzekutiv (origjinal ose kopje e noterizuar)

□ Urdhri i Ekzekutimit (origjinal)

□ Dokument identifikimi

□ Prokura (nëse paraqitet nga përfaqësuesi)

□ Dokumenti i pagesës së tarifës përmbarimore

□ Dokumente të tjera:

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë kërkesë janë të sakta dhe kërkoj fillimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm sipas ligjit.

___, më//20

KËRKUESI / KREDITORI
Emër Mbiemër

(Nënshkrimi)

MODELI NR.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

URDHËR REGJISTRIMI

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, nga kreditori (Emër Mbiemër) është paraqitur kërkesa për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr. ___, datë _____ të Gjykatës _____, të lëshuar për titullin ekzekutiv (aktin që përbën titull ekzekutiv), të protokolluar me nr. ___ Prot., datë ____, me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt: (cito dispozitivin e titullit ekzekutiv/urdhrin e ekzekutimit)

Në bazë të nenit 515 të Kodit të Procedurës Civile dhe Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror",

URDHËROJ

1. Regjistrimin e kërkesës për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit, vendimit nr. , datë , të Gjykatës _____, të lëshuar për titullin ekzekutiv nr., datë .
2. Ngarkohet përmbaruesi gjyqësor (Emër Mbiemër) të kryejë verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në përputhje me nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile dhe:
   a) kur dokumentacioni është i plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore, të fillojë procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm;
   b) kur dokumentacioni paraqet mangësi, t'i kërkojë kreditorit plotësimin e tyre brenda afatit 5 (pesë) ditor;
   c) në rast se mangësitë nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, të kthejë dokumentacionin sipas parashikimeve të nenit 515 të Kodit të Procedurës Civile.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I ZYRËS
(EMËR MBIEMËR)

PËRMBARUESI GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

Marrje dijeni datë: _____

MODELI NR. 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

URDHËR
MBI PËRCAKTIMIN E TARIFËS FIKSE PËRMBARIMORE

Unë, _____, Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, i ngarkuar me ekzekutimin e dosjes përmbarimore nr. _____,

KONSTATOVA:

Pranë kësaj zyre, me Urdhër Regjistrimi nr. _____, datë _____, është regjistruar kërkesa e kreditorit për vënien në ekzekutim të:

- Urdhrit të Ekzekutimit nr. _____, datë _____;
- Titullit Ekzekutiv _____;

me palë:

Kreditor: _____;

Debitor: _____;

Objekti: _____.

Referuar titullit ekzekutiv dhe dokumentacionit të administruar në dosjen përmbarimore, detyrimi objekt ekzekutimi është në vlerën _____ lekë.

Në zbatim të Udhëzimit të Përbashkët nr. 3, datë 15.07.2025, tarifa fikse përbarimore për këtë procedurë përllogaritet në shumën _____ lekë, ndërsa TVSH-ja në shumën _____ lekë.

URDHËROJ:

1. Të përcaktohet tarifa fikse përmbarimore në shumën _____ lekë.
2. Të llogaritet TVSH-ja në shumën _____ lekë.

3. Shuma totale e tarifës përbarimore dhe TVSH-së është _____ lekë.
4. Shuma e mësipërme të regjistrohet në dokumentacionin financiar të dosjes përmbarimore.
5. Tarifa përbarimore dhe TVSH-ja i ngarkohen debitorit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
6. Specialisti i financës, _____ ,pranë Zyrës Permbarimore _____ të hapi faqe partitari ku:

    - Debitori _____ është i detyruar që të paguajë shumën totale tarifë përmbarimore + tvsh në vlerën _____ lekë :

Ky urdhër mbahet në dy kopje, njëra prej të cilave administrohet në dosjen përmbarimore dhe tjetra në zyrën e financës.

PËRMBARUESI GJYQËSOR **FINANCIER**

(Emër Mbiemër) (Emër Mbiemër)

MODELI NR. 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

KËRKESË PËR PLOTËSIM DOKUMENTACIONI PËR VËNIEN NË EKZEKUTIM TË TITULLIT EKZEKUTIV

Drejtuar: (Emër Mbiemër i kreditorit/përfaqësuesit)

Në vijim të kërkesës suaj për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, depozituar pranë kësaj zyre me nr. Prot _____, datë _____, pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur rezulton se nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile.

Konkretisht, konstatohet mungesa e dokumentacionit të mëposhtëm:

- ☐ Titulli Ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar)
- ☐ Urdhri i ekzekutimit (origjinal)
- ☐ Në rastet kur urdhri i ekzekutimit është lëshuar në dispozitivin e vendimit të gjykatës sipas germës a) të nenit 511 të KPC, vendimi duhet në origjinal
- ☐ Dokumenti që provon pagesën e tarifës përmbarimore sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile.
- ☐ sipas rastit prokurën e personit që përfaqëson palën kreditore
- ☐ Kopje të dokumentit të identifikimit
- ☐ Tjetër

Në mbështetje të nenit 515 të Kodit të Procedurës Civile, ju lihet afati 5 ditë nga marrja e kësaj shkrese për plotësimin e mangësive të mësipërme.

Ju bëjmë me dije se në rast se mangësitë nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, dokumentacioni do t'ju kthehet. Në rast se mangësitë plotësohen brenda afatit, kërkesa për vënien në ekzekutim do të konsiderohet e regjistruar që nga data e paraqitjes fillestare pranë përmbaruesit gjyqësor.

PËRMBARUESI GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

VENDIM PËR KTHIMIN E DOKUMENTACIONIT
Baza ligjore: neni 515 i KPC

Drejtuar: (Emër Mbiemër i kreditorit/përfaqësuesit)

Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, pasi shqyrtova kërkesën e kreditorit _____ për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv _____, të paraqitur pranë kësaj zyre më datë _____,

KONSTATOVA:

Gjatë verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, në përputhje me nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile, u konstatuan këto mangësi:

- Me shkresën nr. ____ prot., datë ___, kërkuesit iu kërkua plotësimi i mangësive të konstatuara, duke iu lënë afati 5 (pesë) ditor i parashikuar nga neni 515 i Kodit të Procedurës Civile.

Brenda afatit të caktuar, kërkuesi nuk i ka plotësuar mangësitë e konstatuara.

Në këto kushte, bazuar në nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSA:

1. Kthimin e dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi _____ për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv _____.
2. Kthimi i dokumentacionit bëhet për shkak të mosplotësimit, brenda afatit ligjor, të mangësive të konstatuara sipas nenit 515 të Kodit të Procedurës Civile.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë _____, brenda 5 ditëve nga dita që është njoftuar ose është marrë dijeni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

Lënda: **LAJMËRIM PËR EKZEKUTIM VULLNETAR**
(Baza Ligjore : Neni 517 – 518 i Kodit të Procedurës Civile)

Drejtuar : **DEBITORIT**
Z./Znj. (Emër Atësi Mbiemër, ID)
Adresa :
Cel :
Për dijeni: **KREDITORIT**
Z./Znj. (Emër Mbiemër)
Adresa:

Z./Znj. (Mbiemër),

Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____ në zbatim të Urdhër Regjistrimi nr.__ Prot., datë ____, (Urdhri i transferimit të Kryetarit të Zyrës sipas rastit), nëpërmjet të cilit është regjistruar kërkesa e z./znj. _____, në cilësinë e palës kreditore për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit, Vendimit nr., datë të Gjykatës _____, lëshuar për Titullin Ekzekutiv, Nr. Datë, me palë:
Kreditor:
Debitor:
Objekt: (kthim shume, kthim kredie, detyrim ushqimor, detyrim në të holla)

KONSTATOJ:

Me Urdhrin e Ekzekutimit, Vendimin nr. Datë të Gjykatës (apo Prokurorisë)_____, është vendosur:

- (citohet ddetyrimi sipas dispozitivit të vendimit).

Në Titullin Ekzekutiv nr. Datë ____, është vendosur:

- (citohet detyrimi sipas dispozitivit të vendimit të gjykatës ose pika e dispozitivit që kërkohet të ekzekutohet, apo detyrimi i lindur sipas aktit që përbën titull ekzekutiv).

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 517, 518, 525 të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", Udhëzimit të Përbashkët nr. 3, datë 15.7.2025 "*Për përcaktimin e masës së tarifës fikse të veprimit përmbarimot, llojet e veprimeve përmbarimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara"* të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave,

LAJMËROJ:

1. Të përmbushni vullnetarisht detyrimin tuaj ndaj kreditorit të sipërmendur, shumën prej _____ (lekësh/dollarë/euro) brenda afatit prej (sipas rastit 5 ose 10) ditësh nga data e marrjes së këtij njoftimi.
2. Të paguani tarifën përmbarimore në shumën _____ lekë + 20% tvsh në masën ___ lekë.
3. Derdhja e shumave do të kryhet në llogarinë e Zyrës Përmbarimore Vendore _____, **me numër llogarie _____, në numrin e llogarisë (IBAN_____), pranë Bankës (emrin e bankës).**
4. Nëse detyrimi nuk kryhet vullnetarisht brenda afatit të mësipërm, do të fillojë menjëherë ekzekutimi i detyrueshëm sipas nenit 519 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.
5. Me marrjen e këtij lajmërimi**, ju detyroheni** të deklaroni me shkrim gjëndjen tuaj pasurore si dhe sendet ose kredi që persona të tretë ju detyrohen, si dhe ta përcillni fizikisht ose me postë pranë Zyrës Përmbarimore _____.
6. Mosdeklarimi i gjëndjes pasurore përbën shkelje ligjore dhe mund të sjellë pasoja sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëlidhur formulari i deklaratës së palës debitore.

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

NJOFTIM ME SHPALLJE

Drejtuar: **Gjykatës _____**
Bashkisë _____
Për palën debitore: (Emër Atësi Mbiemër): _____

Për dijeni: Kreditorit
(Emër Mbiemër)
Adresë:
Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, i ngarkuar për ekzekutimin e Urdhrin e Ekzekutimit/Titullit Ekzekutiv nr., datë , me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt:

KONSTATOVA SE:

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, me Urdhër Regjistrimi nr. Prot., datë ..... është regjistruar kërkesa e kreditorit për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr., datë _____, lëshuar për Titullin Ekzekutiv nr., datë .

Me Urdhrin e Ekzekutimit, Vendimin nr. Datë të Gjykatës _____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës).

Në Titullin Ekzekutiv nr. Datë ____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës apo detyrimi i lindur sipas aktit që përbën titull ekzekutiv).

Duke shqyrtuar dokumentacionin e çështjes përmbarimore të regjistruar (përmend në mënyrë të përmbledhur procedurat përmbarimore të ndjekura), rezulton se pala debitore nuk ka marrë dijeni

mbi (aktin përmbarimor konkret që mund të jetë lajmërim për ekzekutim vullnetar, vendim për kalim në ekzekutim të detyrueshëm, urdhër për vendosjen e sekuestros konservative etj), si dhe nga ana e përmbaruesit u morën të gjitha masat e nevojshmet për gjetjen dhe njoftimin e debitorit (përmend veprimet konkrete si kërkesë për informacion zyrës së gjëndjes civile etj), por nuk është bërë i mundur njoftimi i palës debitore.

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 133/a dhe 133/b të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror",

VENDOSA:

1. Të bëjë njoftim me shpallje palës debitore (Emër Atësi Mbiemër): _____.
2. Njoftimi me shpallje të kryhet me anë të afishimit të tij në gjykatën e vendit ku do të gjykohet mosmarrëveshja, në vendim ku debitori ka venbanimin ose vendqëndrimin e tij, si edhe në njësinë administrative në të cilën ka vendqëndrimin ose vendbanimin.
3. Njoftimi botohet edhe në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës.

KRYETAR I ZYRËS
(EMËR MBIEMËR)

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

KËRKESË

PËR EMËRIMIN E PËRFAQËSUESIT TË DEBITORIT SIPAS NENIT 522 TË KODIT TË PROCEDURËS CIVILE

Drejtuar:
Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm _____

KËRKUES:

Përmbaruesi gjyqësor _____, pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____.

PALËT:

Kreditor: _____

Debitor: _____

OBJEKTI:

Emërimi i përfaqësuesit të debitorit, banimi apo vendqëndrimi i të cilit nuk dihet.

BAZA LIGJORE:

Neni 522 i Kodit të Procedurës Civile.

RRETHANAT E ÇËSHTJES

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____ është regjistruar për ekzekutim Urdhri i Ekzekutimit nr. ___, datë ___, i lëshuar nga Gjykata _____ për titullin ekzekutiv _____.

Në kuadër të procedurës përmbarimore janë kryer veprimet e nevojshme për identifikimin dhe njoftimin e debitorit, konkretisht:

- verifikimi i adresës së pasqyruar në titullin ekzekutiv;
- verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- kërkesa për informacion pranë institucioneve kompetente;
- tentativat e njoftimit postar;
- verifikime të tjera të dokumentuara në dosjen përmbarimore.

Pavarësisht veprimeve të mësipërme, nuk është bërë e mundur identifikimi i vendbanimit apo vendqëndrimit të debitorit.

Në këto kushte, në zbatim të nenit 522 të Kodit të Procedurës Civile, për vijimin e rregullt të procedurës së ekzekutimit dhe garantimin e së drejtës së mbrojtjes së debitorit, kërkohet emërimi nga ana e gjykatës i një përfaqësuesi për debitorin.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 522 të Kodit të Procedurës Civile,

KËRKOJ:

1. Emërimin e një përfaqësuesi për debitorin _____, pasi banimi ose vendqëndrimi i tij nuk dihet.
2. Njoftimin e këtij përfaqësuesi për të gjitha veprimet procedurale që do të kryhen në kuadër të procedurës përmbarimore.
3. Dërgimin e vendimit të gjykatës pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____ për vijimin e procedurës së ekzekutimit.

Bashkëlidhur:

- Urdhri i Ekzekutimit;
- Titulli Ekzekutiv;
- Dokumentacioni që provon përpjekjet për gjetjen dhe njoftimin e debitorit;
- Aktet e tjera të dosjes përmbarimore.

PËRMBARUESI GJYQËSOR
(Emër Mbiemër)

MODELI NR. 8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

Lënda: **LAJMËRIM PËR EKZEKUTIM VULLNETAR**
(Baza Ligjore : Neni 517 – 518 i Kodit të Procedurës Civile)

Drejtuar : **DEBITORIT**
Z./Znj. (Emër Mbiemër)
Adresa :
Cel :
Për dijeni: **KREDITORIT**
Z./Znj. (Emër Mbiemër)
Adresa:

Z./Znj. (Mbiemër),
Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, në zbatim të Urdhër Regjistrimi nr.__ Prot., datë ____, (Urdhri i transferimit të Kryetarit të Zyrës sipas rastit) nëpërmjet të cilit është regjistruar kërkesa e z./znj. _____, në cilësinë e palës kreditore për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit, Vendimit nr., datë të Gjykatës _____, lëshuar për Titullin Ekzekutiv, Nr. Datë, me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt: (dorëzim sendi, përmbushje e një detyrimi jo në të holla)

KONSTATOJ

Me Urdhrin e Ekzekutimit, Vendimin nr. Datë të Gjykatës _____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës).

Në Titullin Ekzekutiv nr. Datë ____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës ose pika e dispozitivit që kërkohet të ekzekutohet apo detyrimi i lindur sipas aktit që përbën titull ekzekutiv).

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 517, 518, 525 të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", Udhëzimit të Përbashkët nr. 3, datë 15.7.2025 "*Për përcaktimin e masës së tarifës fikse të veprimit përmbarimot, llojet e veprimeve përmbarimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara"* të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave,

LAJMËROJ:

1. Të përmbushni vullnetarisht detyrimin tuaj ndaj kreditorit të sipërmendur, brenda afatit prej 10 ditësh nga data e marrjes së këtij njoftimi.
2. Të paguani tarifën përmbarimore në shumën _____ lekë + 20% tvsh në masën ___ lekë.
3. Derdhja e shumave do të kryhet në llogarinë e Zyrës Përmbarimore Vendore _____, **me numër llogarie _____, në numrin e llogarisë (IBAN_____), pranë Bankës (emrin e bankës).**
4. Nëse detyrimi nuk kryhet vullnetarisht brenda afatit të mësipërm, do të fillojë menjëherë ekzekutimi i detyrueshëm sipas nenit 519 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

Lënda: **DEKLARATË E PALËS DEBITORE**
(Baza Ligjore : Neni 517 i Kodit të Procedurës Civile)

Unë, nënshkruari/a:
Emri, Mbiemri:
_____
Atësia: _____
Nr. i dokumentit të identifikimit:
_____
Adresa: _____
Cel: _____

Në cilësinë e debitorit në procedurën përmbarimore që po zhvillohet nga:
Përmbaruesi gjyqësor / Zyra Përmbarimore Vendore _____:
Nr. i Urdhrit të Ekzekutimit: ___datë
_____

Duke u bazuar në detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 517, pika 2 të Kodit të Procedurës Civile, deklaroj si vijon:

1. TË DHËNAT PËR GJENDJEN PASURORE

A. Të ardhurat personale
Burimi i të ardhurave (pagë, pension, aktivitet tregtar, të ardhura të tjera):

Shuma mujore neto: _____

B. Llogaritë bankare
(Banka, IBAN, tipi i llogarisë – rrjedhëse / kursimi)

_____
_____

□ Nuk kam llogari bankare.

C. Pasuritë e paluajtshme
(Pronë, apartament, tokë, sipërfaqe, vendndodhje)

_____
_____

□ Nuk kam pasuri të paluajtshme në pronësi.

D. Pasuritë e luajtshme me vlerë
(Autovetura, motoçikleta, makineri, pajisje, sende me vlerë)

_____
_____

□ Nuk kam pasuri të luajtshme me vlerë.

2. KREDITË DHE DETYRIMET NDAJ PERSONAVE TË TRETË

Deklaroj detyrimet aktuale financiare ndaj bankave, institucioneve financiare, apo personave të tretë:

_____
_____

□ Nuk kam detyrime ndaj personave të tretë.

3. KREDI QË PERSONA TË TRETË MË DETYROHEN
(Emri i personit, shuma, origjina e detyrimit)

_____
_____

□ Askush nuk më detyrohet në të holla ose sende.

4. DEKLARATË PËRGJEGJËSIE
am i vetëdijshëm se fshehja e të dhënave, mosdeklarimi ose deklarimi i rremë përbën shkelje të dispozitave ligjore dhe mund të sjellë pasoja sipas legjislacionit në fuqi.

Deklaroj se të gjitha të dhënat e paraqitura më sipër janë të plota, të vërteta dhe në përputhje me gjendjen time aktuale pasurore.
Vendi _____, më _____ / _____ / 202
Debitori
(Emri, mbiemri, nënshkrimi)

MODELI NR. 10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

VENDIM
PËR FILLIMIN E EKZEKUTIMIT TË DETYRUESHËM
(Baza Ligjore : Neni 519 i Kodit të Procedurës Civile)

Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, i ngarkuar për ekzekutimin e Urdhrit të ekzekutimit/Titullit ekzekutiv nr., datë , me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt:

KONSTATOVA SE:

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, me Urdhër Regjistrimi nr. Prot., datë ..... është regjistruar kërkesa e kreditorit për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr., datë _____, lëshuar për Titullin Ekzekutiv nr., datë .

Me Urdhrin e Ekzekutimit, Vendimin nr. Datë të Gjykatës _____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës).

Në Titullin Ekzekutiv nr. Datë ____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës ose pika e dispozitivit që kërkohet të ekzekutohet apo detyrimi i lindur sipas aktit që përbën titull ekzekutiv).

Pala debitore detyrohet të përmbushë detyrimin e përcaktuar në titullin ekzekutiv, të paguajë tarifën përmbarimore në vlerën _____ lekë + 20% tvsh në vlerën _____ lekë.

Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen përmbarimore, rezulton se afati ligjor prej 5 ditësh (në rastet e pagës apo detyrimit ushqimor) ose 10 ditësh (në rastet e tjera) ka kaluar, (konfirmuar me letër porositur nr. Prot, datë në të cilën është firmosur marrja dijeni/refuzuar apo

se kanë kaluar afatet ____ ditë nga njoftimi me shpallje publike) dhe nga ana e palës debitore nuk është kryer ekzekutimi vullnetar i detyrimit të përcaktuar në titullin ekzekutiv të lartpërmendur.

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 519 të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror",

VENDOSA:

1. Fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm ndaj debitorit (Emër Atësi Mbiemër), i datëlindjes _____, për detyrimin që përmban titulli ekzekutiv, (aktin që përbën titulli ekzekutiv), për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr., datë, i Gjykatës _____.
Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, me Urdhër Regjistrimi nr. Prot., datë ..... është regjistruar kërkesa e kreditorit për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr., datë _____, lëshuar për Titullin Ekzekutiv nr., datë , me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt:

Në zbatim të nenit 616, 617, të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", Vendimit nr. Prot., datë "Për pushimin e urdhrit të ekzekutimit", i cili rezulton se ka marrë formë të prerë,

URDHËROJ:

1.Të hiqet masa e sekuestros mbi sendet në emër të palës debitore (Emër Atësi Mbiemër), i datëlindjes _____, të vendosur me urdhër nr. Prot., datë _____.
2.Të informohem mbi procedurat e ndjekura nga ana juaj pas zbatimit të urdhrit, brenda afatit ligjor.

Kundër këtij urdhri që përbën veprim përmbarimor, palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën _____, brenda 5 ditëve nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni.

Ky urdhër mbahet në disa kopje.

KRYETAR I ZYRËS
(EMËR MBIEMËR)

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 57

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

URDHËR
PËR HEQJEN E SEKUESTROS

Drejtuar: **(INSTITUCIONIT QË KA ZBATUAR URDHRIN E SEKUESTROS)**

Për dijeni: **Kreditorit**
(Emër Mbiemër)
Adresë:

Për dijeni: **Debitorit**
(Emër Mbiemër)
Adresë:

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, me Urdhër Regjistrimi nr. Prot., datë ..... është regjistruar kërkesa e kreditorit për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr., datë _____, lëshuar për Titullin Ekzekutiv nr., datë , me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt:

Në kuadër të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, nga ana e përmbaruesit gjyqësor janë ndjekur procedura përmbarimore, ku ndër të tjera me shkresën nr. Prot., datë është urdhëruar vendosja e sekuestros në (përshkruaj sendin apo llogarin ku është vendosur sekuestro).

Në vijim rezulton se (përshkruaj rrethanën prej të cilës lind nevoja e heqjes së sekuestros).

Në kushtet e përmendura si më lart, si dhe bazuar në Kodin e Procedurës Civile dhe Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror",

URDHËROJ:

1. Të hiqet masa e sekuestros mbi sendet në emër të palës debitore (Emër Atësi Mbiemër), i datëlindjes _____, të vendosur me urdhër nr. Prot., datë _____.
2. Të informohem mbi procedurat e ndjekura nga ana juaj pas zbatimit të urdhrit, brenda afatit ligjor.
3. Kundër këtij urdhri që përbën veprim përmbarimor, palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën _____, brenda 5 ditëve nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni.

Ky urdhër mbahet në disa kopje.

KRYETAR I ZYRËS
(EMËR MBIEMËR)

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 58

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

URDHËR
PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS NË DEGËN E THESARIT

Drejtuar:

Degës së Thesarit _____

Për dijeni:

Institucionit Debitor _____

Unë, _____, Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, pasi shqyrtova dokumentacionin e dosjes përmbarimore nr. _____, konstatoj se është paraqitur për ekzekutim:

- Titulli Ekzekutiv _____;
- Urdhri i Ekzekutimit nr. _____, datë _____;
- Kërkesa e kreditorit për ekzekutim;

Pasi debitori:

_____

(njësi e qeverisjes së përgjithshme/institucion buxhetor)

është njoftuar për ekzekutim vullnetar sipas nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk ka ekzekutuar detyrimin brenda afatit ligjor;

Pasi ekzekutimi i detyrimeve monetare ndaj institucioneve buxhetore realizohet sipas nenit 589 të Kodit të Procedurës Civile dhe Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 të Këshillitt ë Ministriave "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit";

Pasi institucioni debitor nuk ka kryer pagesën e detyrimit dhe ekzistojnë kushtet për fillimin e procedurës së ekzekutimit të detyruar nga llogaria e thesarit;

URDHËROJ

1.Vendosjen e masës së sekuestros mbi fondet e institucionit debitor: _____ në Degën e Thesarit _____, deri në masën e detyrimit:

Detyrimi kryesor: _____ lekë
Kamata: _____ lekë
Shpenzime përmbarimore: _____ lekë
Totali: _____ lekë

2. Dega e Thesarit të procedojë sipas parashikimeve të nenit 589 të Kodit të Procedurës Civile dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 të Këshillitt ë Ministriave "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit", për bllokimin dhe transferimin e shumës objekt ekzekutimi.

3.Sekuestroja vendoset vetëm në masën e nevojshme për përmbushjen e detyrimit objekt ekzekutimi.

4.Nuk preken fondet që sipas ligjit dhe udhëzimit përkatës përjashtohen nga masa e sekuestros, përfshirë shpenzimet e domosdoshme për funksionimin e institucionit dhe të ardhurat në burim të Buxhetit të Shtetit.

5.Shuma e mbledhur transferohet në llogarinë:

Përfitues: _____

IBAN: _____

ose në llogarinë përmbarimore sipas procedurës ligjore.

6.Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe është i detyrueshëm për zbatim.

Personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri, do të mbajnë përgjegjësi sipas nenit 606 të KPC si dhe nenit 320 të Kodit Penal.

Kundër këtij urdhri që përbën veprim përmbarimor, palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën _____, brenda 5 ditëve nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni.

Bashkëlidhur:

1. Titulli ekzekutiv;
2. Urdhri i ekzekutimit;
3. Prova e njoftimit për ekzekutim vullnetar;
4. Llogaritja e detyrimit;
5. Dokumentacion tjetër shoqërues.

PËRMBARUES GJYQËSOR

(Emër, Mbiemër)

MODELI NR. 59

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

URDHËR
PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS NË DEGËN E THESARIT

Drejtuar:

Drejtoria e Thesarit / Dega e Thesarit _____

Për dijeni:

Institucioni Debitor _____

Kreditori _____

Unë, _____, Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____,

Pasi shqyrtova dokumentacionin e dosjes përmbarimore nr. _____;

Pasi konstatoj se në zbatim të nenit 589 të Kodit të Procedurës Civile është vendosur masë sekuestroje në Degën e Thesarit mbi fondet e institucionit debitor _____;

Pasi konstatoj se detyrimi objekt ekzekutimi është:

☐ shlyer plotësisht;

☐ procedura përmbarimore është pushuar;

☐ kreditori ka hequr dorë nga ekzekutimi;

☐ ekziston një shkak tjetër ligjor për përfundimin e procedurës së ekzekutimit.

Pasi nuk ekzistojnë më kushtet ligjore për vazhdimin e masës së sekuestros;

Në mbështetje të nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 të Këshillitt ë Ministriave "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit",

URDHËROJ

1.Heqjen e menjëhershme të masës së sekuestros të vendosur mbi fondet e:

Institucioni Debitor: _____

NIPT: _____

Dega e Thesarit: _____

sipas urdhrit të sekuestros nr. _____, datë _____.

2.Dega e Thesarit të procedojë me zhbllokimin e shumës së mbetur të bllokuar dhe rikthimin e gjendjes juridike të llogarisë sipas legjislacionit në fuqi.

3.Të gjitha kufizimet e vendosura në kuadër të procedurës përmbarimore të konsiderohen të shfuqizuara nga data e marrjes së këtij urdhri.

4.Ky urdhër t'i njoftohet:

- Degës së Thesarit _____;
- Institucionit Debitor _____;
- Kreditorit _____;
- çdo institucioni tjetër të përfshirë në procedurën e ekzekutimit.

Personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri, do të mbajnë përgjegjësi sipas nenit 606 dhe nenit 598 të KPC si dhe nenit 320 të Kodit Penal.

Kundër këtij urdhri që përbën veprim përmbarimor, palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën _____, brenda 5 ditëve nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

(Emër, Mbiemër)

MODELI NR. 60

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

KËRKESË PËR QËNDRIM MBI PUSHIMIN E PROCEDURËS PËRMBARIMORE PËR SHKAK TË AMINISTISË SË GJOBËS PENALE

Drejtuar: **(PROKURORISË KOMPETENTE)**

Për dijeni: **Debitorit: (Emër Mbiemër)**
Adresë:

Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, i ngarkuar për ekzekutimin e dosjes përmbarimore nr., datë , me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt:

KONSTATOVA SE:

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, me Urdhër Regjistrimi nr. Prot., datë ..... është regjistruar kërkesa e Prokurorisë për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr., datë _____, lëshuar për vendimin penal nr., datë të Gjykatës _____ .

Me Urdhrin e Ekzekutimit, nr. datë të Prokurorisë _____, është vendosur:

- (citohet dispozitivin e urdhrit të ekzekutimit).

Me Vendimin, nr. datë të Gjykatës _____, është vendosur:

- (citohet dispozitivin e vendimit penal për pjesën që kërkohet të ekzekutohet, dhe bazën ligjore të veprës penale).

(Shpjegohet në mënyrë të përmbledhur procedura e ndjekur për ekzekutimin e vendimit penal)

Nga verifikimet e kryera dhe analiza e dispozitave të ligjit nr., datë "Për dhënie amnistie", rezulton se subjekti debitor _____, në rastin konkret, vlerësohet se përfshihet në kategorinë e subjekteve që përfitojnë nga ky ligj, duke sjellë si pasojë shuarjen e detyrimit penal për pagimin e gjobës.

Megjithatë, referuar nenit 616 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe mungesës së një parashikimi të shprehur për pushimin e procedurës përmbarimore nga ana e përmbaruesit në rastet kur debitori është subjekt që plotëson kriteret e parashikuara në ligjin për amnistinë, çmohet e nevojshme marrja e një qëndrimi nga ana e organit të prokurprisë, si organi kontrollues në ndjekjen e ekzekutimit të vendimeve penale.

Për sa më sipër, kërkohet nga ana juaj:

- Të shpreheni lidhur me vijimin apo pushimni e procedurës përmbarimore në fjalë në bazë të nenit 616/b të Kodit të Procedurës Civile;
- Nëse e vlerësoni të arsyeshme marrjen e masave nga ana juaj për shfuqizimin e urdhrit të ekzekutimit të lëshuar nga ana juaj si prokurori kompetente dhe të na e vini në dispozicion, kjo bazuar në praktikat e ndjekura nga disa prokurori.

Ky qëdrim kërkohet me qëllim që përmbaruesi gjyqësor t'i japi zgjidhje ligjore procedurës përmbarimore, në përputhje me nenin 616 të Kodit të Procedurës Civile.

Bashkëlidhur po ju përcjellim kopje të njehsuar të akteve përmbarimore të ndjekura për ekzekutimin e gjobës penale në fjalë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të qëndrimit tuaj.

KRYETAR I ZYRËS
(EMËR MBIEMËR)

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 61

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

KËRKESË PËR MARRJEN E MASAVE PËRE KONVERTIMIN E GJOBËS PENALE NË DËNIM ME BURGIM, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË SË EKZEKUTIMIT
(Baza ligjore: neni 43 I Ligjit nr. 79/2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale")

Drejtuar: **(PROKURORISË KOMPETENTE)**

Për dijeni: **Debitorit: (Emër Mbiemër)**
Adresë:

Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, i ngarkuar për ekzekutimin e dosjes përmbarimore nr., datë , me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt:

KONSTATOVA SE:

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, me Urdhër Regjistrimi nr. Prot., datë ..... është regjistruar kërkesa e Prokurorisë për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr., datë _____, lëshuar për vendimin penal nr., datë të Gjykatës _____ .

Me Urdhrin e Ekzekutimit, nr. datë të Prokurorisë _____, është vendosur:

- (citohet dispozitivin e urdhrit të ekzekutimit).

Me Vendimin, nr. datë të Gjykatës _____, është vendosur:

- (citohet dispozitivin e vendimit penal për pjesën që kërkohet të ekzekutohet, dhe bazën ligjore të veprës penale).

Në kuadër të ekzekutimit të këtij titulli ekzekutiv janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme përmbarimore, konkertisht: (Shpjegohet në mënyrë të detajuar procedurën e ndjekur për ekzekutimin e vendimit penal)

Nga verifikimet e kryera rezulton se debitori ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për shlyerjen, tërësisht apo pjesërisht, të detyrimit që rrjedh nga gjoba penale, për shkak të mungesës së pasurisë, si dhe për shkak se ASHK kërkon aplikimin online të zbatimit të urdhrit të sekuestros, kundrejt tarifave kadastrale që në bazë të nenit 525 të KPC i parapaguan pala kreditore, apo për shkak të rrethanave të tjera ku përmbaruesi gjyqësor gjendet në pamundësin për ta ekzekutuar gjobën penale.

Në këto kushte, duke qenë se përmbaruesi gjyqësor ka ezauruar mjetet ligjore për ekzekutimin e detyrimit dhe është në pamundësi për ekzekutimin e gjobës penale, bazuar në nenin 43 të Ligjit nr. 79/2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", kërkohet nga ana juaj:

- Të merrni masat përkatëse për t'iu drejtuar gjykatës kompetente me kërkesë për konvertimin e gjobës penale me burg;
- Të dakordësoni pezullimin e veprimeve përmbarimore deri në disponim me vendim nga gjykata, si dhe pas dispozitivit nga gjykata të paraqisni kërkesë për pushimin e ekzekutimit të gjobës penale në bazë të nenit 616 të KPC.

Bashkëlidhur po ju përcjellim kopje të njehsuar të akteve përmbarimore të ndjekura për ekzekutimin e gjobës penale në fjalë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të qëndrimit tuaj.

KRYETAR I ZYRËS
(EMËR MBIEMËR)

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 62

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

VENDIM
PËR CAKTIMIN E DITËS SË EKZEKUTIMIT

Drejtuar: **Kreditorit**
(Emër Mbiemër)
Adresë:

Drejtuar: **Debitorit**
(Emër Mbiemër)
Adresë:

Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, i ngarkuar për ekzekutimin e Urdhrin e Ekzekutimit nr., datë , me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt:

KONSTATOVA SE:

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, me Urdhër Regjistrimi nr. Prot., datë ..... është regjistruar kërkesa e kreditorit për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr., datë _____, lëshuar për Titullin Ekzekutiv nr., datë .

Me Urdhrin e Ekzekutimit, Vendimin nr. Datë të Gjykatës _____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës).

Në Titullin Ekzekutiv nr. Datë ____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës apo detyrimi i lindur sipas aktit që përbën titull ekzekutiv).

Duke shqyrtuar dokumentacionin e çështjes përmbarimore të regjistruar, nevojitet të kryhen veprimet procedurale në terren (përshkruaj veprimin konkret që do të kryhet), në funksion të ekzekutimit të Urdhrit të Ekzekutimit nr. , datë të Gjykatës_____.

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 519 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror",

VENDOSA:

1. Të kryejë procedurat përmbarimore (përshkruaj veprimin konkret që do të kryhet) në datën _____, ora _____, në adresën: _____, në funksion të ekzekutimit të Urdhrit të Ekzekutimit nr. __, datë ____ të Gjykatës _____.

Kundër këtij vendimi që përbën veprim përmbarimor, palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën _____, brenda 5 ditëve nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni.

Ky vendim mbahet në disa kopje.

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 63

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

KËRKESË PËR BASHKËPUNIM NË EKZEKUTIM TË DETYRUESHËM

Drejtuar: **NJËSISË ADMINISTRATIVE TË QEVERISJES VENDORE**

KOMISARIATIT TË POLICISË VENDORE _____

Për dijeni: **Kreditorit (Emër Mbiemër)**
Adresë:

Debitorit: (Emër Mbiemër)
Adresë:

Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, i ngarkuar për ekzekutimin e dosjes përmbarimore nr., datë , me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt:

KONSTATOVA SE:

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, me Urdhër Regjistrimi nr. Prot., datë ..... është regjistruar kërkesa e kreditorit për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr., datë _____, lëshuar për Titullin Ekzekutiv nr., datë .

Me Urdhrin e Ekzekutimit, Vendimin nr. Datë të Gjykatës _____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës).

Në Titullin Ekzekutiv nr. Datë ____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës apo detyrimi i lindur sipas aktit që përbën titull ekzekutiv).

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 523 të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", Urdhrit nr. ____ Prot., datë _____ për vënien e sekuestros konservative dhe inventarizimin e sendeve të luajtshme,

KËRKOJ:

1. Bashkëpunimin tuaj për ekzekutimin e detyrueshëm të Urdhrit të Ekzekutimit nr. ___, datë ____, në datë, ndaj debitorit _____, duke qënë të pranishëm në datën ____, ora ____, në adresën _____.
2. Në kuadër të veprimeve procedurale që duhet të kryhen në terren, veprimi përmbarimor kërkon hyrjen në ambientet e debitorit, inventarizimin e sendeve të luajtshme, vendosjen e sekuestros konservative, hartimin e procesverbalit përkatës sipas neneve 542 – 543 të Kodit të Procedurës Civile.
3. Konfirmimin e pjesëmarrjes tuaj brenda afatit të arsyeshëm, duke qenë se mungesa e bashkëpunimit cenon zbatimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit.

Personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri, do të mbajnë përgjegjësi sipas nenit 606 të KPC si dhe nenit 320 të Kodit Penal.

KRYETAR I ZYRËS
(EMËR MBIEMËR)

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 64

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

KËRKESË PËR BASHKËPUNIM NË EKZEKUTIM TË DETYRUESHËM

Drejtuar: **(Institucioneve që i drejtohet)**

Për dijeni: **Kreditorit (Emër Mbiemër)**
Adresë:

Debitorit: (Emër Mbiemër)
Adresë:

Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, i ngarkuar për ekzekutimin e dosjes përmbarimore nr., datë , me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt:

KONSTATOVA SE:

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, me Urdhër Regjistrimi nr. Prot., datë ..... është regjistruar kërkesa e kreditorit për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr., datë _____, lëshuar për Titullin Ekzekutiv nr., datë .

Me Urdhrin e Ekzekutimit, Vendimin nr. Datë të Gjykatës _____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës).

Në Titullin Ekzekutiv nr. Datë ____, është vendosur:

- (citohet dispozitivi i vendimit të gjykatës apo detyrimi i lindur sipas aktit që përbën titull ekzekutiv).

(Shpjegohet në mënyrë të përmbledhur procedura e ndjekur)

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 523 të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror",

KËRKOJ:

4. Bashkëpunimin tuaj për ekzekutimin e detyrueshëm të Urdhrit të Ekzekutimit nr. ___, datë ____, në datë, ndaj debitorit _____, duke qënë të pranishëm në datën ____, ora ____, në adresën _____.
5. Në kuadër të veprimeve procedurale që duhet të kryhen në terren dhe duke qenë se objekti i ekzekutimit kërkon (procedura konkrete që do të kryhet)
6. Konfirmimin e pjesëmarrjes tuaj brenda afatit të arsyeshëm, duke qenë se mungesa e bashkëpunimit cenon zbatimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit.

Personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri, do të mbajnë përgjegjësi sipas nenit 606 të KPC si dhe nenit 320 të Kodit Penal.

KRYETAR I ZYRËS
(EMËR MBIEMËR)

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

MODELI NR. 65

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____

Nr._____prot. _____, më___.___.202_
Nr.. _____Dosje.

VENDIM PËR GJOBITJEN E DEBITORIT/PERSONIT TE DETYRUAR
(Baza ligjore: neni 606 i KPC)

Drejtuar: **BANKA E NIVELIT TË DYTË**
Punonjësi bankar përgjegjës
(Emër Mbiemër)
Adresë:

Për dijeni: **Kreditorit**
Emër Mbiemër)
Adresë:

Debitorit
(Emër Mbiemër)
Adresë:

Unë (Emër Mbiemër) përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, i ngarkuar për ekzekutimin e Urdhrin e Ekzekutimit nr., datë , me palë:

Kreditor:
Debitor:
Objekt:

KONSTATOVA SE:

Pranë Zyrës Përmbarimore Vendore _____, me Urdhër Regjistrimi nr. Prot., datë ..... është regjistruar kërkesa e kreditorit për vënien në ekzekutim të Urdhrit të Ekzekutimit nr., datë _____, lëshuar për Titullin Ekzekutiv nr., datë .

Në kuadër të procedurës së ekzekutimit, me shkresën nr. ___, datë ___, është kërkuar nga debitori apo personi i detyruar _____ të kryej veprimin e ëprcaktuar në dispozitivin e titullit ekzekutiv.

Nga verifikimet e kryera rezulton se edhe pse pala debitore apo personi ka marrë dijeni (konfirmuar me letrën e porositur nr., datë) është (refuzuar, ka kryer në mënyrë të parregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është I detyruar).

Ky veprim apo mosveprim përbën shkelje të detyrimeve ligjore të parashikuara në nenin 606 të Kodit të Procedurës Civile.

Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror",

VENDOSA:

1. Të gjobisë debitorin/personin e detyruar _____ (emër atësi mbiemër), me gjobë në masën _____ (deri në 50 000) lekë, se ka refuzuar, ka kryer në mënyrë të parregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është i detyruar.
2. Kundër këtij vendimi që përbën veprim përmbarimor, palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën _____, brenda 5 ditëve nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni.

Ky vendim mbahet në disa kopje.

PËRMBARUES GJYQËSOR
(EMËR MBIEMËR)

Udhëzim nr. 1, datë 29.06.2026 i Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit "Për procedurën e regjistrimit të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëherëshëm të mbrojtjes nga Zyrat Përmbarimore Vendore"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr._____prot. Tiranë, më___.___.2026

UDHËZIM

Nr. _1_, datë 29_. 6_. 2026

"PËR
PROCEDURËN E REGJISTRIMIT DHE EKZEKUTIMIT TË MENJËHERSHËM TË URDHRAVE TË MBROJTJES DHE URDHRAVE TË MENJEHERSHËM TË MBROJTJES NGA ZYRAT PËRMBARIMORE VENDORE"

Në mbështetje të nenit 8, shkronja "b" dhe "c", të ligjit nr. 8/2023 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit,

U DH Ë Z O N:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.Qëllimi i këtij udhëzimi është unifikimi i procedurave të regjistrimit dhe ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes nga zyrat përmbarimore vendore, duke garantuar zbatimin e tyre të menjëhershëm, efektiv dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjit nr. 11/2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", me synim mbrojtjen e jetës, shëndetit, integritetit fizik e psikologjik, dinjitetit dhe të drejtave të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

2.Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative e procedurale që ndiqen nga zyrat përmbarimore vendore për regjistrimin e menjehërshëm të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes të përcjellë nga gjykatat kompetente, fillimin dhe zhvillimin e procedurës së ekzekutimit të tyre në përputhje me

legjislacionin në fuqi, bashkërendimin e veprimeve me gjykatat, Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera përgjegjëse për garantimin e ekzekutimit efektiv të këtyre urdhrave si dhe unifikimin e praktikës së zyrave përmbarimore vendore në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes.

KREU II
REGJISTRIMI I URDHRAVE TË MBROJTJES DHE URDHRAVE TË MENJËHERSHËM TË MBROJTJES

1.Çdo urdhër mbrojtjeje dhe urdhër i mënjehërshëm i mbrojtjes, i përcjellë nga gjykatat kompetente pranë zyrës përmbarimore vendore, regjistrohet menjëherë në regjistrin e çështjeve përmbarimore dhe procedura e ekzekutimit fillon pa vonesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.Kryetari i zyrës përmbarimore vendore merr masat e nevojshme organizative për të garantuar regjistrimin, trajtimin me përparësi dhe ekzekutimin në kohë të këtyre çështjeve nga përmbaruesit gjyqësorë, duke mbikëqyrur respektimin e këtij udhëzimi.

3.Për urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes të përcjellë zyrtarisht nga gjykata kompetente pranë zyrës përmbarimore vendore për ekzekutim, përcjellja e tyre përbën bazë të mjaftueshme për fillimin e procedurës së ekzekutimit, pa qenë e nevojshme paraqitja e kërkesës të veçantë nga viktima.

4.Kryetari i zyrës përmbarimore vendore nxjerr menjëherë urdhrin e regjistrimit të urdhrit të mbrojtjes dhe urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, dhe ngarkon përmbaruesin gjyqësor për fillimin e procedurës së ekzekutimit, duke kryer veprimet e nevojshme procedurale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.Mungesa e paraqitjes personale të viktimës ose e një kërkese të veçantë për ekzekutim nuk përbën shkak për mos nxjerrjen e urdhrit të regjistrimit, mosfillimin apo vonimin e procedurës së ekzekutimit të urdhrit të mbrojtjes dhe urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, kur këto janë përcjellë zyrtarisht nga gjykata për ekzekutim, sipas legjitimitetit që i jep ligji nr. 11/2026 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”.

6.Në zbatimin e këtj kreu, ligjit nr. 11/2026 dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesi gjyqësor shtetëror vepron me përparësi pa vonesë, duke respektuar karakterin urgjent të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive dhe të menjëhershëm të viktimës.

KREU III
PROCEDURA E EKZEKUTIMIT DHE KALIMI MENJËHERË NË EKZEKUTIM TË DETYRUESHËM

1.Pas marrjes në dijeni të urdhrit të regjistrimit të urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, përmbaruesi gjyqësor shtetëror fillon menjëherë procedurën e ekzekutimit dhe ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin efektiv të detyrimeve të përcaktuara në titullin ekzekutiv.

2.Procedura e ekzekutimit zhvillohet me përparësi ndaj çështjeve të tjera përmbarimore, duke pasur në konsideratë natyrën urgjente të urdhrit dhe nevojën për garantimin e mbrojtjes së menjëhershme të viktimës.

3.Përmbaruesi gjyqësor shtetëror kryen pa vonesë të gjitha veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimit e urdhrit, duke bashkëpunuar sipas rastit, me Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e tij.

4.Gjatë ekzekutimit të urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, përmbaruesi gjyqësor shtetëror merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar efektivitetin e ekzekutimit, sigurinë e viktimës dhe respektimin e detyrimeve të vendosura nga gjykata.

5.Çdo vonesë e pajustifikuar në fillimin ose kryerjen e veprimeve përmbarimore përbën shkelje administrative dhe trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.Për shkak të natyrës urgjente të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive të viktimës, përmbaruesi gjyqësor shtetëror kalon menjëherë në ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve të përcaktuara në titullin ekzekutiv, pa patur nevojë të kryej lajmërim për ekzekutim vullnetar.

7.Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ndërmerr pa vonesë të gjitha veprimet përmbarimore të nevojshme për zbatimin efektiv të urdhrit, duke kërkuar, sipas rastit, mbështetjen e Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera kompetente.

8.Veprimet përmbarimore kryhen në mënyrë të tillë që të garantojnë mbrojtjen e menjëhershme të viktimës, respektimin e detyrimeve të vendosura nga gjykata dhe parandalimin e çdo veprimi që mund të cenojë jetën, shëndetin, integritetin ose sigurinë e saj.

9.Duke qenë se urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes janë në ekzekutim të vazhdueshëm, pushimi i ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit do të kryhet pas përfundimit të afatit të përcaktuar në dispozitivin e urdhrit të mbrojtjes apo urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

Përmbaruesi gjyqësor shtetëror nuk mund të ndërpresë ekzekutimin e urdhrit përpara këtij afati, përveç rasteve kur gjykata ka vendosur shprehimisht ndryshe.

10.Në rastet kur gjykata, në dispozitivin e vendimit, ka urdhëruar moskryerjen e një veprimi të caktuar nga dhunuesi, përmbaruesi gjyqësor shtetëror i dërgon menjëherë kësaj pale një njoftim zyrtar mbi detyrimin për moskryerjen e veprimit të ndaluar, si dhe mbi sanksionet ligjore që parashikohen në rast të moszbatimit të urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Ky njoftim i dërgohet për dijeni edhe viktimës, me qëllim sigurimin e transparencës dhe mbrojtjes së saj.

KREU IV
BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL

1.Gjatë ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, përmbaruesi gjyqësor shtetëror bashkëpunon me Policinë e Shtetit, në përputhje me kompetencat e secilit institucion dhe legjislacionin në fuqi.

2.Kur për ekzekutimin e urdhrit kërkohet garantimi i rendit dhe sigurisë, parandalimi i kundërshtimit ose mbrojtja e viktimës, përmbaruesi gjyqësor shtetëror kërkon asistencën e Policisë së Shtetit, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

3.Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit synon garantimin e ekzekutimit të plotë dhe të menjëhershëm të urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, duke respektuar kompetencat ligjore të secilit institucion.

4. Gjatë procedurës së ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, përmbaruesi gjyqësor shtetëror bashkëpunon, sipas rastit, me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për këtë qëllim, Kryetari i zyrës përmbarimore vendore cakton pika kontakti ndërmjet përmbaruesve dhe përfaqësuesve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, si dhe siguron komunikim të rregullt dhe shkëmbim informacioni për rastet konkrete..

5. Bashkëpunimi me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit ka për qëllim lehtësimin e shkëmbimit institucional të informacionit dhe koordinimin e veprimeve që ndihmojnë në zbatimin efektiv të urdhrit të mbrojtjes, pa cenuar kompetencat e institucioneve pjesëmarrëse.

6. Zbatimi i këtij udhëzimi nuk bie ndesh me përgjegjësitë dhe procedurat e institucioneve pjesë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

KREU V
MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI

1.Kryetarët e zyrave përmbarimore vendore mbikëqyrin zbatimin e këtij udhëzimi dhe marrin masat e nevojshme organizative për garantimin e regjistrimit dhe ekzekutimit të menjëhershëm të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes.

2.Kryetarët e zyrave përmbarimore vendore dhe përmbaruesit gjyqësor sigurojnë që këto çështje të trajtohen me përparësi, duke monitoruar respektimin e afateve dhe kryerjen në kohë të veprimeve përmbarimore nga përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë.

3.Kur konstatohen vonesa, mosveprime ose shkelje të dispozitave të këtij udhëzimi, kryetari i zyrës përmbarimore vendore informon Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit, sipas rastit.

4.Kryetarët e zyrave përmbarimore vendore bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit për zbatimin e njëtrajtshëm të këtij udhëzimi dhe për përmirësimin e praktikës së ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes.

5.Kryetarët e zyrave përmbarimore vendore raportojnë periodikisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit mbi zbatimin e këtij udhëzimi, sipas formës dhe afateve të miratuara me urdhër nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.

6.Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit analizon të dhënat e raportuara, monitoron zbatimin e njëtrajtshëm të këtij udhëzimi.

KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1.Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë dhe kryetarët e zyrave përmbarimore vendore janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij udhëzimi, në përputhje me kompetencat e tyre dhe legjislacionin në fuqi.

2.Moszbatimi ose zbatimi i parregullt i dispozitave të këtij udhëzimi përbën moszbatim të detyrave funksionale dhe trajtohet në përputhje me ligjin nr. 8/2023, për përgjegjësinë disiplinore të punonjësve të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe u njoftohet të gjitha zyrave përmbarimore vendore për zbatim.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ERGYS QIRICI

Udhëzim nr. 2, datë 30.06.2026 i Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit "Për procedurën e ekzekutimit të titujve ekzekutivë me objekt 'Takim fëmije' dhe 'Marrje e fëmijës në kujdestari' dhe asistencën psikologut gjatë ekzekutimit nga zyrat përmbarimore vendore"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr._____prot. Tiranë, më___.___.2026

UDHËZIM

Nr. _2_, datë 30. _6_. 2026

**"PËR
PROCEDURËN E EKZEKUTIMIT TË TITUJVE EKZEKUTIVË ME OBJEKT "TAKIM FËMIJE" DHE "MARRJE E FËMIJËS NË KUJDESTARI", SI DHE ASISTENCËN E PSIKOLOGUT GJATË EKZEKUTIMIT NGA ZYRAT PËRMBARIMORE VENDORE"**

Në mbështetje të nenit 8, shkronja "b" dhe "c", nenit 41, pika 4 të ligjit nr. 8/2023, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit,

U DH Ë Z O N:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.Qëllimi i këtij udhëzimi është unifikimi i procedurave të ekzekutimit të titujve ekzekutivë me objekt "takim fëmije" dhe "marrje e fëmijës në kujdestari" nga zyrat përmbarimore vendore, në përputhje me nenin 523 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 41 të ligjit nr. 8/2023 dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Ky udhëzim synon të përcaktojë rolin dhe mënyrën e angazhimit të psikologut gjatë ekzekutimit, të shmangë praktikën e pajustifikuar të caktimit të ekspertimeve psikologjike si kusht paraprak për ekzekutimin, të reduktojë vonesat dhe kostot e panevojshme procedurale, si dhe të orientojë veprimet e përmbaruesit gjyqësor në rastet e refuzimit të vazhdueshëm të fëmijës për të realizuar takimin me prindin tjetër.

2.Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave administrative dhe procedurale për ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt "takim fëmije" dhe "marrje e fëmijës në kujdestari", unifikimi i praktikës së zyrave përmbarimore vendore, përcaktimi i rolit dhe mënyrës së angazhimit të psikologut gjatë ekzekutimit, si dhe orientimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor

në rastet kur fëmija refuzon në mënyrë të vazhdueshme realizimin e takimit me prindin tjetër, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

KREU II
ASISTENCA E PSIKOLOGUT

1Në ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt "takim fëmije" ose "marrje e fëmijës në kujdestari", përmbaruesi gjyqësor kërkon asistencën e psikologut, në përputhje me nenin 523 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 41, pika 4, të ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror".

2.Asistenca e psikologut ka për qëllim mbështetjen e përmbaruesit gjyqësor gjatë ekzekutimit, lehtësimin e komunikimit me fëmijën, krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për realizimin e takimit dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

3.Angazhimi i psikologut sipas këtij udhëzimi nuk përbën ekspertim psikologjik dhe nuk shoqërohet me hartimin e raportit psikologjik, përveç rasteve kur ekspertimi është urdhëruar shprehimisht nga gjykata ose parashikohet nga ligji.

4.Përmbaruesi gjyqësor nuk nxjerr vendim për caktimin e ekspertit psikolog vetëm për hartimin e një raporti psikologjik si kusht paraprak për fillimin, vazhdimin ose përfundimin e ekzekutimit. Prania e psikologut gjatë ekzekutimit sigurohet vetëm në funksion të asistencës profesionale të parashikuar nga ligji.

5.Psikologu, gjatë ekzekutimit: a) asiston përmbaruesin gjyqësor në komunikimin me fëmijën dhe palët; b) kontribuon në uljen e tensioneve dhe konfliktit ndërmjet palëve; c) mbështet krijimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e takimit, pa cenuar vullnetin dhe interesin më të lartë të fëmijës.

6.Psikologu nuk zëvendëson kompetencat e gjykatës dhe nuk vlerëson apo vendos mbi të drejtën e takimit, mënyrën e ushtrimit të saj ose ndryshimin e masave të përcaktuara në titullin ekzekutiv. Përmbaruesi gjyqësor ekzekuton vendimin vetëm sipas dispozitivit të titullit ekzekutiv.

KREU III
PROCEDURA E EKZEKUTIMIT

1.Përmbaruesi gjyqësor organizon ekzekutimin e titullit ekzekutiv në përputhje me dispozitivin e vendimit gjyqësor, duke njoftuar paraprakisht palët, njësinë për mbrojtjen e fëmijës dhe psikologun, sipas parashikimeve ligjore.

2.Gjatë çdo ekzekutimi mbahet procesverbal në përputhje me nenin 524 të Kodit të Procedurës Civile, ku pasqyrohen, ndër të tjera, prania ose mungesa e palëve, e psikologut dhe e përfaqësuesit

të njësisë për mbrojtjen e fëmijës, qëndrimi i fëmijës, deklarimet e palëve, si dhe çdo rrethanë tjetër me rëndësi për ekzekutimin.

3.Në rast se fëmija refuzon të realizojë takimin me prindin tjetër, përmbaruesi gjyqësor nuk përdor forcë fizike apo mjete shtrënguese ndaj fëmijës. Psikologu asiston në komunikimin me fëmijën dhe palët, me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për realizimin vullnetar të takimit, duke respektuar interesin më të lartë të fëmijës.

4.Refuzimi i fëmijës dokumentohet në procesverbal, së bashku me shpjegimet e dhëna nga fëmija, nëse ai është në gjendje t'i shprehë ato, si dhe me konstatimet e përmbaruesit gjyqësor dhe të psikologut lidhur me ecurinë e procesit të ekzekutimit.

5.Mosparaqitja e psikologut në datën dhe orën e njoftuar nga përmbaruesi gjyqësor, kur ai është njoftuar rregullisht, nuk përbën shkak për shtyrjen ose moszhvillimin e ekzekutimit. Në këtë rast, përmbaruesi vijon procedurën e ekzekutimit dhe pasqyron mungesën e psikologut në procesverbal.

6.Në rastet kur refuzimi i fëmijës përsëritet në mënyrë të vazhdueshme, përmbaruesi gjyqësor dokumenton në procesverbal çdo tentativë ekzekutimi dhe nuk urdhëron kryerjen e ekspertimeve psikologjike të përsëritura, përveç rasteve kur ato janë urdhëruar nga gjykata. Përmbaruesi orienton palët t'i drejtohen gjykatës kompetente për rivlerësimin e mënyrës së ushtrimit të së drejtës së takimit, nëse kjo vlerësohet e nevojshme.

KREU IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1.Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë dhe kryetarët e zyrave përmbarimore vendore janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij udhëzimi, në përputhje me kompetencat e tyre dhe legjislacionin në fuqi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe u njoftohet të gjitha zyrave përmbarimore vendore për zbatim.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ERGYS QIRICI